

Jakov Milaj

Raca shqiptare

Studim Anthropologjik E Historik

Ismail Mal' Osmani, Botonjës -

Tiranë

1944

PARATHËNJE

Të përgatitësh një studim anthropologjik e historik pa qënë as athropolog as historian, duhet të keshë shumë guxim. E unë këtë guxim e mora, pse desha të plotsojë, me sa më qe e mundur, një nevojë të madhe shpirtore, një mungesë që duhet të ketë ndjerë Shqiptari : njohjen e vetvetes.

E kaluara dhe e arthmja e një kombi ndjekin një rrugë të caktuar, drejtimin e së cilës, më tepër se fati, e japin fuqit biologjike. Prandaj, po të kërkojmë thellë thellë shkaqet e lulzimit ose të teposhtes së një populli, do të hasim, në çdo rasje, në faktorë biologjikë.

Thesari m'i çëmuar i një shteti nuk përbëhet prej pasuris së tokës e së nëntokës së tij dhe prej mundësive të zhvillimit ekonomik, por prej njerzve q'ai shtet mban në gji, prej shpirtit q'i u jep gjallëri këtyre njerzve, prej gjakut që qarkullon nëpër venat e tyre. Raca, si pas mendimit të të gjithë biologve, përcakton prirjet shpirtore të një populli, kanalizon dëshirat e mendimet, rregullon, pa e kuptuar, jetën e individve, qoftë në pjesën vehtiake, qoftë në mardhënje me shoqi shojnë.

Ky studim nuk është bërë për t'u marrë me racizëm në kuptimin politiko-filozofik që i japin këtij skaji popujt e tjerë të botës. Në një vënt si ky i yni, ku nuk njihen as fillet e shkencave biologjike dhe ku nuk dihet, as në vija të përgjithëshme, se cila është paja morfologjike e shpirtore që ne na bën të çquhemi nga popujt e tjerë të Ballkanit e t'Evropës, të hidhet në shesh një ide e këtillë do t'ishte gjë fare e papjekur dhe nuk do të jipte asnjë përfundim praktik.

Qëllimi i hartimit të kësaj vepre ka qënë që të nxjerë në shesh disa të vërteta, gjer më sot të panjohura, mbi racën t'onë dhe t'u japë shkas, atyreve q'e ndjejnë vehten të zotin, për t'u marrë pak më tepër me biologji e me anthropologji.

Përfundimet që ka për të nxjerë lexonjsi nga këto faqe janë të thjeshta dhe, ndofta, të njohura intuitivisht prej shumë Shqiptarvet, rne gjithë se të mohuara prej të huajvet dashakeqë : se populli arbëror ka një origjinë të vetme e të përbashkët; se është anas (aukton) në të gjitha viset ku banon sot; se as midis myslimanvet e kristjanvet, as midis Gegvet e Toskvet nuk ka ndonjë ndryshim racor; e, më në funt, se ndihet nevoja për një politikë shoqërore që të synojë fuqizimin fizik të racës shqiptare.

Kombi i ynë ndodhet, siç munt të kuptohet lehtëzi, në kushte shumë të mira për sa i takon racës. Me njëri tjetrin nuk na lith vetëm gjuha e historia, por edhe gjaku e prandaj kemi trajta trupore e veçori shpirtrore të përbashkëta.

Më sa, në cilin do nga shtetet e tjera të Kontinentit t'onë gjejmë më shumë se një racë, me tipare fiziologjike e psikike të ndryshme, në Shqipëri kemi vetëm racën ilirike ose dinarike të çëmuar edhe prej racistëve më orthodoxë si një nga racat më të larta, më të gjalla e me shpirt të pajosur me cilsi të zgjedhura. Njësija e racës duhet të ketë rëndësi të madhe për Kombin t'ënë të mitur, pse nga kjo rrjeth diçka e rëndësishme : divergjencat mendore e shpirtrore ndërmjet Shqiptarvet duhet të jenë shumë të vogla, aspiratat kombëtare të përbashkëta.

Ç'paradoks — kishte për të thënë ndonjë lexonjës — me njëmëndsin (realitetin)! Po të jetë kështu, shkenca nuk i përgjigjet së vërtetës... Nuk po shihni se si Shqiptarët po orvaten t'i hanë kokën shoqi shojtë ?

Por unë kujtoj se kjo armiqsi e sotme nuk ka asnjë themel. Është një krizë shpirtrore e çastit dhe e shëruarshme, një farë nevralgjije që do të kalojë mbrënda pak kohe.

Mbushen plotë pesë vjetë që ndodhemi në luftë, në një luftë të tmerrëshme ku raca, popuj e idera po përleshën si kurrë ndonjë herë tjetër. Valët e përthyerat të kësaj ndeshje kaq të madhe duhet të ndiheshin edhe në vëndin t'ënë. Këtu takuan tokë djerre, por pjellore, mëndje të padjallzuara, ndërgjegje të patrajtuara sa e si duhet e prandaj bënë veprën e tyre. Mëkati, pra, për këtë gjëndje q'u kriiua, nuk është i racës e, për rrjedhim, jo i turmës shqiptare, por — pse mos t'a themi? — i atyreve q'u takonte barra t'a lëronin këtë turmë, i udhëheqësve të sajë të djeshëm intelektualë e politikanë

që kanë punuar pak, shumë pak, për të njohur psikën e Shqiptarit, për të kuptuar prirjet e mbëhit e sajë dhe për t'u dhënë atyreve drejtimin e duhur.

Ndofta — t'a përmëndim edhe këtë — kemi të bëjmë me një fatalitet historik me rrënjë përjashta botës s'onë. Për kombet e tjera, përpara se luftëtari t'i drejtojë shigjetën e funtme armikut q'e mbante nën zgjedhë dhe politikani të përpiqet të sjellë bashkimin e mbrëndshëm ose të bëjë politikanizëm, punoi historjani, filozofi, hartisti, shkencëtari i cilës do dege. Në Shqipëri, për shkak të rrethanave që nuk mvareshin prej nesh, mëndjet drejtonjse munguan gjatë periudhës së Rilindjes. Vetëm harti, letërsija, beri diçka për të mëkëmbur ndërgjegjen kombëtare, e cila, gjer në vjetët e mbramë të tetqindshit, venitej në lethargjin e rëndë që patën krijuar tri a katër vargje shekujsh robërije. Por edhe drita e tij qe shumë e zbehtë dhe rruga për t'arritur pikën e synimit shumë e

vështirë pse krejt e parratur. Vullnetet e ndërgjegjet e reja, q'ishin të domosdoshme për t'i dhënë jetë një shteti të pavarur jo vetëm politikisht por edhe shpirtërisht, nuk u krijuan dot.

Sido qoftë, gjëndja e sotëshme ka të bëjë vetëm me faktorë të jashtëm e jo me pajën shpirtore t'ethnosit t'ënë e prandaj do të përmirsohet shumë shpejtë pa lënë vrraga përçarje. Jemi, që të gjithë, bij të një race të vetme, vllazër; shpejtë do t'i njohim gabimet që kemi bërë e do t'i kërkojmë ndjesë shoqi shojtë. Gjaku uj s'bëhet.

Për të caktuar fatin që na ruhet për të nesërmen, kemi një a tout të madhe në dorë : përnjësin (uniformitetin) e brumit që përbën Kombin t'ënë. Në qoftë se intelektualët e ndërgjegjshëm do t'i përvishen me mish e me shpirt' punës që të zbulojnë problemet shpirtore e lëndore të fisit arbëror dhe t'u gjejnë atyreve zgjidhjen e drejtë, nuk duhet të trëmbemi për t'arthmen. Vetëm duhet punë, pun' e parreshtur mendimtarësh të vërtetë.

Kjo punë është shumë m'e rëndë tek ne se sa te popujt e tjerë të botës. Duhet nisur prej themelit. Është mirë t'i njohim ë t'i themi vetë të metat t'ona: jemi një popull anakronik n'Evropën e sotëshme. Ne s'e kemi trajtuar akoma ndërgjegjen kombëtare, kurse kombet e tjera kanë shkuar shumë përpara. Por, me gjithë vështirësi e mëdha që paraqiten, munt t'i a dalim çdo pengimi. Raca e jonë i ka dhënë botës së huaj vlefta të larta e të shumta në përpjestim me numrin e përfaqsonjësve të sajë. Ajo ruan, sigurisht, energji të mëdha edhe sot e kësaj dite. Këto energji do të nxjerin, me doemos,shkëndi xixllonjse që do t'a ndriçojnë këtë popull dhe do t'i tregojnë drejtimin që duhet ndjekur.

Por, përpara së gjithash, detyrohemi të gërmojmë veçorit e lëndës së grestë që përbën popullin t'ënë. Një kirurg nuk do t'u a dilte asnjë herë në krye operaçioneve që bën po mos të njëjtte imtësisht shtretrit anatomikë të pjesës ku do të vërë thikën. Gjithashtu, një intelektual ose burr shteti do t'i mbrapshtonte shumë punët në vënt që t'i çonte në rrugë të mbarë, po mos të njëjtte si duhet popullin në të cilin edhe ai bën pjesë.

— Gnothi safton, i tha Orakulli i Delfit filozofit Sokrat.

Qëllimi q'u ndoq në hartimin e kësaj vepre ka qënë shumë i kufizuar. Është përmëndur edhe më parë : t'i jipet rasja lexonjsit të thjeshtë që të nxëjë disa të vërteta rreth racës së tij, të dijë se midis tij dhe atyreve që flasin një gjuhë me të nuk ka asnjë ndryshim gjaku e pra t'a njohë Shqiptarin, që prej Mitrovice e gjer në skajin më jugor të Çamëris, si vllan e vetë.

Gjuha e përdorur është e thjeshtë dhe, për të bërë që teksti të kuptohet lehtë, janë mbledhur, në një kaptinë të veçantë, disa shënime e sqarime biologjike të vulgarizuara. Rrjeshtimi i lëndës është bërë në mënyrë që seicili lexonjës të gjejë diçka që t'a interesojë. Pranë pjesëve me përmbajtje vetëm biologjike, janë shtjelluar subjekte ethnografikë e historikë.

Por kam shpresë se edhe intelektual i paspecjalizuar n'anthropologji e në histori do t'i lexojë me interes këto pak faqe. Janë, me sa di unë, të parat që shkruhen mbi racën t'onë në gjuhën shqipe e prandaj shumë-kushit nuk do t'i ketë rënë rasja që të mirret me problemet që qeken në këtë vepër.

Për të mundur të konsultojë sa më shumë nga studimet e autorvet të huaj që janë marrë me anthropologjin e me çështje të tjera shqiptare, kam qënë i detyruar t'ë marrë hua libra nëpër miq, të çqetsojë ndokënd që të më përkthejë ndonjë vepër prej gjermanishtes e të kërkojë këshilla nga ata që janë më të zotë se unë. Duke i u dhënë funt këtyre rreshtave, e ndjej për detyrë t'i u falem nderit me zëmër që të gjithve.

Tiranë, Jenar 1944.

AUTORI

I. RACA DHE KOMBI

Ç' ËSHT ANTHROPOLOGJIJA - PËRKUFIZIMI I RACËS - LIGJËT E MENDEL-it - SHËNIME
ANTHROPOMETRIKE - KLASIFIKIMI I RACAVET DHE RACA ARJANE - METIÇJATI - RACA, KOMBI, GJUHA

Ndryshimet e fytyrës e të mënyrës së jetesës i u kanë rënë në sy vëzhgonjësve që në kohët më të lashta. Ndër dokumentat e hieroglifuar t'Egjyptjanvet gjënden përshkrime të shumta popujsh që kishin marrëdhënie me nënshtetasit e Faraonvet. Bibla, në kaptinën e dhjetë të Gjenezës (të bërët) përmban një dokument të famshëm ethnologjik të kohës. Ndër Grekë e Latinë, pastaj, kemi shënime të shumta e vepra të tëra ku fise e raca të ndryshme të dheut përshkruhen për bukuri duke u ndjekur një farë sistemi shkencor. Mjafton të përmenden emrat e Herodotit, Aristotelit, Tacitit e Plinit të Vjetër për të kuptuar se shumë ndër eksponentët e mendimit helenik e italik i kanë kushtuar me zell studime të vlefshme atyre shkencave që sot thirren ethnografi, ethnologji e anthropologji.

Studimet shumzohen gjatë Mesjetës dhe zënë vënt kryesor në numrin e diturive të kohës, atëherë kur Evropjanët mundën të zbulojnë kontinente të reja dhe të hyjnë thellë nëpër ato që njiheshin edhe ndër kohët e moçme. Më në fund, në shekullin e nëntmëdhjetë, njoftimet e mbledhura mbi dukjen e mbi zakonet e njerëzve disiplinohen, caktohen vijat që duhen ndjekur për kërkimet e reja dhe arrihet, në këtë mënyrë, në shkencat e vërteta që përbëjnë historin natyrore të njeriut.

Emri i anthropologjis është i vjetër: e përdor Aristoteli në kuptimin e fjalimit mbi njerin e do t'a përdorin gjer në ditët t'ona filozofët me domethënie e një doktrine të natyrës njerzore. Nga mezi i shekullit të shkuar ky skaj përhapet si sinonim i "historis natyrore të njeriut" (Broca) dhe përhapja e tij bën që të lihet pas dore kuptimi filozofik.

Skajet ethnografi e ethnologji q'e kanë rrënjën në konceptin e popullit (gërqiisht ethnos) janë të kohëve të reja. Përkufizime të qarta mbi to mungojnë edhe sot e kësaj dite, pse dijetarë të shteteve të ndryshme i u japin kuptime që nuk përputhen

kryekëput njëri me tjetrin. Me gjithë këtë, përmbajtja e ethnografis është përcaktuar, në përgjithsi, në kuptimin e një disipline thjeshtësisht përshkronjëse, e cila ka për barrë mbledhjen e lëndës q'është për

t'u vretur mbi kulturat e sotëshme të popujve të ndryshëm. Ethnologjia është shkencë krahasonjëse e induktive që ka për detyrë përpunimin e mëpastajshëm dhe diskutimin e kësaj lënde së mbledhur.

Por prap të dy skajet nuk janë përdorur vetëm në këtë kuptim. Shumë herë nën emrin “shkencë antropologjike” dijetarët kanë përmblodhur ethnologjinë së bashku me anthropologjinë. Kurse, duke pranuar njësinë e këtyre dy disiplinave, përdorimi shkencor italian e ka mbajtur të ndarë anthropologjinë — studimi i problemeve biologjike, sistematike e racore të njeriut — nga ethnologjia që studjon grumbullimet dhe kulturat e njerzve. 1)

Fjala “racë” është përmendur shumë ndër këta vjetët e fundit. Ku me kuptimin shkencor, ku me kuptimin e një doktrine politike që ka marrë emrin racizëm e që ka krijuar bazën e lëvizjeve politike të disa popujve.

Ky studim nuk ka për qëllim që të hyjë thellë në anthropologji, as të mirret me çështje filozofike abstrakte ose me racizëm e prandaj, për t'i dhënë lexonjësit rasje që të marrë vesh ç'është raca, po japim disa përkufizime të hartuara prej shkencëtarësh rrymash të ndryshme e që nuk bjenë në kundërshtim, por e plotsojnë shoqi shojnë.

“Raca, thot Guenther, përfaqson një grup njerzor që, për lidhjet ndërmjet veçorive fizike dhe pajosive shpirtore të veçanta, dallohet nga cilido grup tjetër njerzor dhe krijon elementa që i përngajnë njëri tjetrit.” 2)

Eugen Fischer, që është një ndër më të mëdhenjtë eksponentë të racizmit gjenetik, e përkufizon me këto fjalë racën: “është një trunk i përcaktuar nga grupe “genësh” 3) të barabartë, jo prej njerzish që i përngajnë shoqi shojtë vetëm ndër trajta të përjashtëme : është një grup që trashgohet.4)

Alessandro Ghigi thot: “sistematiku munt të pohojë që raca është një entitet i dalluarshëm për një sasi karakteresh morfologjike e fiziologjike të përcjellëshme me anën e trashgimit, që duken ose, sido qoftë, që munt të zbulohen me metodat e verës së zakonëshme e të statistikës.” 5)

Nga këto tri përkufizime të rëndësishme del në shesh se shumica e shkencëtarve me fjalën racë nuk përfshijnë vetëm njerz që kanë veçori somatike krejtësisht të njëjta, por që kanë, bashkë me trajtat e përjashtëme, të përngjarëshme edhe disa cilsi shpirti që i afrojnë midis tyre e që trashgohen prej atit e nënës te bijt e bijat.

Shkencëtarë të tjerë nuk i japin rëndësi kaq të madhe pjesës shpirtrore. Një ndër ta, Boule, jep këtë përkufizim : “për racë duhet kuptuar vazhdimtarija e një tipi fizik që shpreh afërsit e gjakut dhe që përfaqson një grupëzim kryesisht natyror duke mos patur në përgjithsi asgjë të përbashkët me popullin. me kombësin, me gjuhën e me zakonet që janë grupëzime këmb' e krye artificiale dhe aspak anthropologjike dhe që s'kanë të bëjnë veçse me historin, mbasi janë prodhime të sajë.” 6)

Pikërisht këtu ngul këmbë edhe De Lapouge: “raca është përmbledhja e disa individve që kanë të përbashkët një farë tipi të trashguarshëm; nocioni i racës është i rendit zoologjik, vetëm zoologjik.” 7)

Por, për këtë vepër do t'ishte ndofta m'i përshtatshëm përkufizimi i Martial-it që i u shtëmënet rymave politike, nuk lë përjashta pajën shpirtërore dhe i jep rëndësi kryesore historis: “Thirret racë përmbledhja e një popullsije, karakteret psikologjike të së cilës, të fshehura ose të çfaqura (posaçërisht gjuha) dhe vizat anthropobiologjike përbëjnë mbrënda kohës (historis) një njësi të dalluar.” 8)

1) Renato BIASUTTI : “Origine e sviluppo delle scienze anthropologiche”, në Razze e Popoli della Terra, faqe 13, 14, 15.

2) J. EVOLA : “Mito del sangue”, Hoepli, Milano, 1942, faqe 2.

3) Fuqija që kanë gametët (spermatozoidët dhe ovulët) për të shkaktuar dukjen e veçorive somatike të posaçme, i veshet pranis, në nukleo, të lëndëve kimike të veçanta që thirren me emrin “faktorë”, “determinantë” ose “genë”. Morgani dhe shkolla e tij i mbajnë “genët” si thërmije që kanë seli të caktuar ndër kromozomë.

4) J. EVOLA : Op. cit. faqe 92 - 93.

5) Alessandro GHIGI : “Problemi Biologici della Razza e del Meticcio”, Nicola Zanichelli Editore, Bologna, 1939, faqe 8.

6) Eugène PITTARD : “Les races et l'histoire”, Albin Michel Editeur, Paris, 1932, faqe 4.

7) Giovanni MARRO : “Primato della Razza Italiana, Casa Editrice Giuseppe Pincipato, Milano, Messina, 1940. Faqe 50.

8) Dr. René MARTIAL : “Race, Hérité, Folie”, Mercure de France, Paris, 1938, faqe 1. - Kaptina e parë e këtij libri është përkthyer shqip prej Autorit të kësaj vepre dhe është botuar në “Përpyekja Shqiptare”, Viti i dytë, faqe 386.

Ky përkufizim cakton edhe programin e përgjithshëm të punës s'onë në të cilën flitet për origjinën dhe për lëvizjet më të mëdha historike të racës shqiptare, përshkruhen vizat morfologjike dhe kufizohet puna mbrënda kufijve toksorë që përmbajnë ata përfaqsonjës të racës që flasin një gjuhë të vetme, shqipen.

Për t'a afruar lexonjsin më tepër me një nga problemet themelore të racës, me trashgimin, më duhet lë flas pak mbi ligjet që e rregullojnë këtë. Kuptohet qartaz se nuk do të kishte pse të flitej për origjinën ilire të Shqiptarve e për pastërtin e racës së tyre nga elementa të huaj, po të mos ishin zbuluar ligje me saktësi matematike që rregullojnë kalimin e veçorive trupore e shpirtore të njerëzve prej një brezi në brezat e ardhshëm.

Vetë Darwin-i kishte nxjerë në shesh fakte të rëndësishme duke studjuar dukjen dhe shpërndarjen e disa karaktereve ndër ibridë. Weismann-i shpreh konceptin e vazhdimis së plazmës germinative të prindërve ndër fëmij e prandaj, gjer në një farë pike, të pavdeksis së sajë. Tashi dimë se kjo vazhdimi, e prandaj ruajtja e karaktereve të njeriut, njëmëndsohet (realizohet) me anën e kromozomëve, që janë trupa të vogjël të ngjyrosur, në numër të caktuar për setcilën specie e që përmbahen prej të gjitha qelizave (çelulave) të farës s'organizmave bimore e shtazore. F. Galton hartoi pastaj teorin e trashgimis atavike, si pas së cilës grumbulli i cilsive të një individi i u detyrohet jo vetëm prindërvet, por edhe gjyshërvet e stërgjyshërvet në mënyrë zvoglonjse (dekreshente) me largësin e brezave. Por kjo teori, me gjithë se e përmirsuar nga Pearson, nuk puqet krejtësisht me teorit e hartuara nga Mendel-i.

Në vitin 1865-66, një murg austriak, Grigor Mendel, mbillte në kopshtin e kuvëndit pizele e bimë të tjera dhe kryqëzonte varietetet e ndryshme për të shikuar se si trashgoheshin ndër ibridët karakteret e tyre. Zbuloi nga këto vëzhgime tri ligjë biologjike me rëndësi kryekreje që nuk bënë përshtypje të madhe atëherë kur u botuan për herë të parë, por që më vonë, më 1900, u vërtetuan prej tre botanikësh të ndryshëm dhe formuan, që prej kësaj kohe, themelin e një disipline të re që shkoi përpara me hapa shumë të shpejta, të gjenetikës.

Prej kësaj kohe u ndie nevoja që të kërkoheshin e të zgjidheshin edhe për njerin problemet e ndryshme të trashgimis e t'ibridizmit. Në këtë mënyrë gjenetika u fut n'anthropologji. Studimet e bëra gjer më sot tregojnë se në trashgimin e shumë veçorive të ndara (si ngjyra e syvet, ngjyra dhe trajta e flokëvet, trajta e hundës, shumë sëmundje q'i sjell individi me vehte kur lind etj...) vërtetohen plotësisht të tri ligjët e Mendel-it. Të thjeshtësuara ato munt të shprehen në këtë mënyrë:

1. — **LIGJA E ZOTRIMIT OSE E UNIFORMITETIT** : kur kryqëzohen dy bimë o kafshë, që ndrojnë njëra prej tjetrës për një karakter të vetëm, i cili karakter në njërën është zotronjës dhe në tjetrën i mbëshehur, ne brezin e parë shihet vetëm karakteri zotronjës.

SHËMBULL I: duke mbarsur një pizel me fara të verdha me polinën e një pizeli me fara të blerta, të gjitha farat e para që na jep ky kryqzim janë të verdha, pse ngjyra e verdhë është zotronjëse mbi ngjyrën e blertë.

SHËMBULL II: Po të kryqzojmë bimën “gojë e luanit” me lule të kuqe me një tjetër me lule të bardha, lejnë lule me ngjyrë të ndërmjeme: gojë luani me ngjyrë trëndafili.

2. — **LIGJA E NDARJES SË KARAKTEREVE** : në qoftë se mbarsen njëra me tjetrën fara me origjinë të kryqëzuar, në brezin e dytë ato japin fara që kanë karakterin zotronjës (të verdha në shëmbullin e parë) dhe fara që kanë karakterin e mbëshehur (të blerta po n'atë shëmbull), në një përpjestim të qëndruarshëm 3:1 (pra, në katër, tri fara të verdha dhe një të blertë). Në shëmbullin e dytë, të gojës së luanit, nga të cilët një e katërta është me lule të kuqe, një e katërta me lule të bardha dhe dy të katërtat janë me lule ngjyrë trëndafili.

3. — **LIGJA E PASTËRTIS SË GAMETEVE NDËR IBRIDËT:** në qoftë se mbillen pizele të brezit të dytë, do të kemi një brez të tretë, në të cilin dallohet:

a) Pizelet e blerta prodhojnë vetëm pizele të blerta ;

b) farat e verdha, në dukje omogjene, në brezin e trete japin një të tretën e farave me ngjyrë të verdhë, që nuk e ndryshon më ngjyrën ndër brezat e ardhëshëm;

c) dy të tretat që mbetën japin një përzjerje farash te verdha e të blerta në raportin 3:1, një soj si në brezin e dytë,

ç) këto farat e fundit — të verdha e të blerta bashkë, si pas raportit mendeljian 3:1 — ndjekin tri rregullat e mësipërme, do me thënë farat e blerta prodhojnë vetëm fara të blerta, farat e verdha prodhojnë fara të verdha të pastërta dhe fara të verdha që japin fara në dy ngjyra si pas raportit të mësipërm.

Në brezin e parë (I) kemi “fëmij” me karaktere të përziera; në brezin e dytë (II) duken karakteret fillestare në gjysmën e “fëmijvet”; në brezin e tretë (III) karakteret fillestare duken edhe në gjysmën tjetër të “fëmijve” që, në krye, dukesh sikur kishin vetëm karaktere të përziera.

Në brezin e parë (I), trashgimija m'e dobët (shënuar me katrorin e bardhë) duket sikur ka humbur, por del prap në shesh në brezin e dytë (II) e në të tretin (III). Në brezin e tretë (III) kjo trashgimi len edhe nga “bijt” ku, në brezin e dytë, dukej sikur kishte humbur.

Sa thamë më sipër tregon se gametët mbeten të pastërt sa do që bima është ibride, pra e përzierë.

Kjo ligjë e tretë do të vlente edhe për trashgimet e ndryshme, shpirtore ose trupore, të species njerzore. Veçorit që trashgohen munt të përcillen (transmetohen) edhe veç e veç. pa patur me doemos marrëdhënje midis tyre. Prandaj është gabim të çfaqen gjykime të papjekura rreth karakterit të një individi duke u mbështetur vetëm mbi pamjen e tij fizike. Kjo gjë do t'ishte e drejtë vetëm sikur të kishim përpara syve kryqëzimin e dy përfaqsonjësve të dy racave të pastërta. Por praktikisht dy raca njerzore krejt të pastërta është e pamundur të gjënden n'Evropë. Kuptohet pra se një njeri me dukje të racës nordike, i hollë, i gjatë, flokverdhë, nuk ka me doemos cilsira shpirtore të kësaj race; nga ana tjetër, munt të ngjajë dëndur që në një shtat trashalluk të shkurtër të një brakiqefali të gjëndet një shpirt nordik.

Nga pikpamja e “seleksionimit të racës”, sikur theorit e Mendel-it të jenë të vërteta edhe për farën njerzore, rrjeth se, sikur të ndalojmë për disa breza me radhë çdo kryqzim t'ibridve të një race me elementa të një race tjetër, në pjellën do të kemi dal' e nga dalë shpërndarjen e veçorive të përziera. Me anën e kësaj shpërndarje do t'arrijmë, më në funt, të kemi veçorit origjinale krejt të pastra: e atëherë, duke veçuar mbajtësit e këtyre cilsive të cilat që në fillim kanë shkatrruar një racë — racën nordike, për shëmbull — do të kemi prapë racën e pastër të njëherëshme. Duke u mbështetur në mendelizmin teorik Gjermanija nacional-socialiste ka marrë masa për Aufnordung-un, do me thënë për rikthimin e popullit tedeshk në racën “nordike”. Kjo doktrinë, gjithashtu — në lidhje me ridaljen e papritur të një karakteri të futur në varguan e trashgimit me anën e një elementi biologjik të sëmurë — ka frymëzuar racizmin gjerman; për të marrë masat e ndryshme që kanë bërë kaq shumë bujë rreth hygjienës e rreth profilaksit të racës.

Por a do të jetë vallë i sigurtë përfundimi i këtyre masave, ashtu siç thonë ligjët e gjenetikës ? Shkencëtarët jo gjermanë nuk janë të njëj mendimi mbi përfundimin pozitiv të Aufnordung-ut e të profilaksit të racës.

9) Spjegime të qarta e të shumta mbi këtë argument jep H. S. JENNINGS në veprën e vetë “Ereditá biologica e Natura umana”, përkthyer prej anglishtes nga Prof. Paolo ENRIQUES, e botuar në A. Mondadori, Milano, 1934. Të shifen sidomos faqet 211-212 e tutje.

Anthropologjia, për të studjuar një grup njerzish, mbështetet në disa masa e përshkrime të një pjese individësh për të cilët besohet se përfaqsojnë grupin. Mbështetet, prandaj, në probabilitetin, i cili i afrohet më tepër së vërtetës sa m'i math te jetë numri i vëzhgimeve.

Karakteret somatike që do t'i duhen më shumë lexonjsit të këtij libri janë këto:

1. — NGJYRA E LËKURËS: nuk është i lehtë caktimi i sajë, pse racat e ndryshme kanë ngjyra që i u përngjajnë shumë njëra tjetrës dhe që nuk ka se si të përshkruhen me fjalë. Përveç ngjyrës së përgjithëshme të një race janë edhe ato të cilatdo individi veçanërisht. Shkenca, për t'i bërë ball këtij studimi të ngatrruar, përdor shkallën kromatike të Von Luschan-it në të cilën ngjyrat e lëkurës, nga m'e qarta gjer te m'e errta, ndahen në tetë klasë dhe secila klasë ndër numra që shkojnë nga 1 deri në 36. Racat që mbajnë numrat më të vegjël, pse më të bardha, janë ato që rrethojnë Baltikun dhe detin e Veriut, kurse më t'errtat, q'arrijnë në ngjyrën gati të zezë, janë ato të zonave tropikale të Sudanit.

Ngjyra ka rëndësi të veçantë në caktimin e racave, pse ajo nuk shtohet ose paksohet prej ambientit sikurse munt të besojnë ata që shohin trupat të nxirë prej rrezeve të diellit, por është e trashëguarshme në pjellë edhe kur ambienti ndryshohet. Zezaku i Afrikës mbetet i zi edhe kur len e rritet n'Evropën e veriut, ndër sa Evropjani bardhosh që ka kaluar verën lakuriq në ndonjë ranishtë fillon të marrë prap ngjyrën që kishte porsa nis punën e tij të përditëshme në hije.

2- — NGJYRA E SYVET mvaret nga dy ngjyra t'agut (iridit) nga të cilat njëra ndodhet në sipërfaqen e mbrëndëshme, tjetra në të jashtmen. Ndër albinët (sybardhët) këto ngjyra mungojnë që të dyja dhe agu merr nga gjaku ngjyrën e trëndafilin. Në syt bojë qielli mungon vetëm ngjyra e jashtme, kurse e mbrëndëshmja është e kuqe e çelët, Edhe në syt ngjyrë ulliri të hapët thuaj se mungon ngjyra e përparshme e agut, por kjo shtohet gjithnjë e më tepër në syt me ag ngjyrë gështenje t'errët dhe të zezë. Në trashgimin ngjyra e syvet ndjek ligjet mendeljane.

3. — EDHE NGJYRA E FLOKVET jepet prej dy ngjyrash: njëra e verdhë në të skuqur përhapet barabar në të gjithë qimen dhe tjetra e gështenjtë përhapet si pluhur në kokrra të vogla. Kur kjo e fundit mungon, flokët janë të kuqë. Edhe për flokët është vërtetuar mendelizmi: flokët e gështenjtë, për shëmbull, nuk janë prodhimi mesatar që rrjeth nga kryqzimi i një flok-verdhi me një flok-zi, por përbëjnë një karakter të pavarur. Ka rëndësi të dihet edhe se ngjyra m'e errët është zotronjse mbi ngjyrën më të hapët, por kjo vlen vetëm për të rriturit; fëmijit shumë herë kanë flokë me bojë të çelët që vijnë duke u nxirë me kalimin e moshës.

4. — TRAJTA E FLOKVET DHE GRADA E LESHTORIS.

Kemi dy trajta të ndryshme flokësh: flokë të përdredhur të shkurtër e të hollë dhe flokë të drejtë të gjatë e të trashë. Por një sasi e madhe trajtash të ndërmjeme ka shkaktuar që këto të mblidhen në tri kategori: elikotrikë (në trajtë të spirales), flokë të përdredhur a kaçurrela; cimotrikë, me valë; lisotrikë të drejtë të trashë dhe shumë a pak t'ashpër, të përngjarshëm deri diku me lelën e kalit.

Ndër rasje kryqëzimesh midis njerzish me flokë që kanë trajtë të ndryshme është vënë re se zbatohen pikërisht ligjët e Mendel-it.

Shkalla e leshtoris duket se ka lidhje të ngushtë me trajtën e flokvet, Me gjithë se përfaqson një karakter njerzor parak (primitiv), duket se atë e kanë humbur të gjithë lisotrikët që janë gati qose dhe një pjesë e elikotrikvet, ndërsa e kanë ruajtur të gjithë cimotrikët.

5. — LARTËSIJA E TRUPIT të njeriut (mashkullit të pjekur) më këmbë ndryshon nga 120 në 190 centimetra. Shumica e madhe e njerzve janë të lartë prej 142 në 180 centimetra. Shtati i gruas është mesatarisht 12 centimetra më ulët nga ai i burrit.

Lartësit e shtatit ndahen prej anthropologve në tetë klasë:

Shtate shumë të ulta deri 147.9 cm. Kl. I.

Shtate t'ulta prej 148 deri 152.9 cm. " II.

" 153 " 157.9 " " III.

Shtate të mesme " 158 " 162.9 " " IV.

" 162 " 167.9 " " V.

Shtate të larta " 168 " 172.9 " " VI.

" 173 " 177.9 " " VII

Shtate shumë të larta " 178 cm. e përpjetë " VIII.

Njerzit e gjatë gjënden përgjithësisht ndër vende të hapta, si ndër zona me klimë të butë ashtu në zonën tropikale.

Përveç lartësis së shtatit, antropologu i u jep rëndësi të veçantë edhe përpjestimeve të pjesve të ndryshme të trupit. Matet, për shëmbull, gjatsija e shalës, e krahut dhe e segmenteve të tyre, diametrat transversalë të bustit, trajta e syrit dhe e kapakëve të tij etj....

Ndër kohët e fundit u fol shumë edhe për grupëzimet e gjakut, por hë-për-hë dallimi i racave të ndryshme si pas grupeve që: paraqiten prej individve nuk ka hyrë prerë në shkencë.

6. — TRAJTA E FYTYRËS DHE TREGONJSI I SAJË. Ndryshimet fizionomike që bjenë më tepër në sy mvaren nga ndryshimet e eshtrave që përbëjnë fytyrën, dhe pjesët e tjera të kafkës që ndodhen afër sajë. Mbi një sipërfaqe shumë të vogël anatomike paraqitet gama m'e gjërë e ndryshimeve morfologjike. Disa nga veçorit nuk munt të maten e prandaj bëhet përshkrimi i tyre, disa të tjera nuk munt të diktohen veçse ndër kafka pa mish, kurse ka veçorira që munt t'analizohen me anë masash mbi njerin e gjallë dhe janë pikërisht dimensionet absolute e relative të fytyrës dhe dimensionet e hundës.

Tregonji fizionomik i fytyrës është raporti në mes të lartësis nasion-mento 10) dhe të gjërësis më të madhe e cila gjëndet duke matur hapsirën në mes të dy zigomeve (mollzave të faqes). Në tregonjsin morfologjik të fytyrës mirret si skaj krahasimi gjërsija e sajë dhe flitet për fytyra të shkurtra, te mesme ose të gjata.

Tregonji morfologjik i fytyrës ndryshon në mes të 73.4 e 93.7; që do të thotë se lartësija nga nasion në mjekër është 7 ose 9 të dhjeta të gjërsis më të madhe bizigomatike.

7. — TRAJTA E HUNDËS DHE TREGONJSI I SAJË. Përveç ndryshimeve të profilit ka rëndësi trajta dhe gjërsija ,e flegravet (vrimavet të hundës). Tregonji hundak është raporti qe rrjeth nga gjërsija m'e madhe e flegravet dhe lartësija e përgjithëshme e hundës. Ky tregonjës kalon mesatarisht prej 60.4 gjer në 112.1. Në bazë të tregonjsit hundak kemi hunda të holla e të gjata (leptorrine: deri në 70), hunda te mesme (mesorrine : prej 70 deri në 85) dhe hunda të sheshme ose të shtypura (platirrine : prej 85 e tutje.)

10) "Nasion" : pika e pjekjes s'eshtrave të hundës me ashtin e ballit. "Mento" ose "gnation" : pika m'e ulët e ashtit të nofullës, nën mjekër.

8. — TREGONJSI QEFALIK u fut në shkencë nga Svedezi Retzius më 1842. Po të shikojmë një tok rrashtash nga ana e sipërme, do të vëmë re se disa nga ata janë të gjatë e disa të tjerë të shkurtër. Prandaj Retzius propozoi që njerzit të dallohen si pas kryes, në dolikoqefalë ose kokë-gjatë dhe në brakiqefalë ose kokë-shkurtër. Midis dy grupeve Rroca shtoi atë të kokavet mesatare ose mesoqefale ose mesatqefale. Për caktimin e këtyre trajtave u muar për bazë tregonjsi qefalik që përfaqson raportin në mes të diametrit transversal të një koke dhe të diametrit gjatësor shumëzuar per 100:

$$TQ = \text{Diametri transversal} \times 100 / \text{Diametri gjatësor}$$

Një kafkë është dolikoqefale kur ky raport është m'i vogël se 75; mesoqefale kur ndryshon prej 75 në 80; brakiqefale kur kalon numrin 80. G. Sergi ka vërtetuar se zona e ndërmjeme nuk ka autonomi morfologjike e se, në të vërtetë, kemi vetëm “dy kategori natyrore të ndara prej tregonjsit 80.

Dy dimensionet e sipërme dhe lartësija e kafkës kanë rëndësi të madhe, pse mesatarja e tyre, e marë me katër shifra, është moduli i kryes dhe i përgjigjet afërsisht kapacitetit të kafkës në centimetra kubë.

Dikur u fol shumë për kapacitetin e kafkës, pse ky lidhej ngushtë me vëllimin e truve e, si rrjedhim, me fuqin mendore të një race. Më vonë, pas provave dhe matjeve të shumta, u vërtetua se tru i vëllimshëm nuk do të thotë fuqi mendore m'e madhe dhe tru i vogël fuqi mendore m'e dobët. Gjenit që kanë dalë nga racat e ndryshme kanë pasur një tru që, i matur, ka pasur një vëllim prej një mij gjer në dy mij centimetra kubë. Shumica e truve të këtyre gjenive ka një vëllim që sillet rreth mesatares (1500 cmk.). Kur kapaciteti i kafkës së një njeriu është m'i vogël se një mij cmk ose m'i math se dy mij cmk, atë-herë kemi të bëjmë me idiotër e me rasje patologjike. 11)

Duke u mbështetur në përfundimet e anthropometris e në përshkrimet somatike të bëra prej shkenctarvet, shumë anthropologë kanë dashur të klasifikojnë një herë e mirë racat e ndryshme të botës. Nga këto klasifikime fatin më të math e ka pasur ai i Eickstedt-it si pas të cilit familja e Hominidae përbëhet prej një gjinije të çdukur Pithecanthropus dhe të gjinis Homo. Kjo gjini përbëhet nga një specie e çdukur Homo Neaderthalensis dhe nga specia e madhe e përbashkët Homo sapiens ose Homo Recens. Kjo pastaj ndahet më nën-specie e në seri dhe serit në raca.

Për të thjeshtësuar punë, n'emërtimin e racavet po marr për bazë sistemin e Biasutti-t që është një nga më të rinjt e më të përsosurit. Si pas tij, suaza e trajtave të sotëshme t'ominidvet ndahet në katër cikle: cikli i trajtave primare ekuatorjale me degën e Australoidvet e të Negroidvet ; cikli i

trajtavet primare boreale me degën e Mongoloidvet e t'Europoidvet ; cikli i racavet të rrjedhura sub-ekuatorjale : cikli i racavet të rrjedhura t'Oqeanit Paqsor e t'Amerikës.

Dega e Europoidvet ndahet në dy grupe: ai i pre-europid-vet që përfshin racat Ainuide, Uralidë e Lapide dhe ai i europidvet që ndahet në dy nën-grupe: në nën-grupin evropjan dhe në nën-grupin afro-aziatik. I pari përmbledh racat që neve na hyjnë në punë më tepër: Nordide (veriake), Mediterranide (mesdhetare), Adriatide ose Dinarike ose Ilirike, Baltide, Alpide. Në të dytin nën-grup hyjnë racat Berberide, Orientalide, Armenide, Assiride, Turanide dhe Indide.

Mbrënda kësaj suaze së pjesëshme të racavet njerzore, nuk është përmendur një emër që dëgjohet e sbkruhet më dëndur se cilido tjetër në kohë të sotëshme: raca arjane. Pa dashur të hyjmë në theorit raciste që ndryshojnë dita ditës e prej shteti në shtet:, për të mos lënë lexonjsin n'errësirë, po përmëdim vetëm se ky skaj i ri është krijuar në këta vjetët e fundit ndër popujt evropjanë në të cilët është ngjallur ndërgjegja e racës dhe urrejtja për popullin ebraik.

“Shprehja raca arjane duhet marrë në këtë kuptim: zbritja nga një grup trajtash racore që janë formuar dhe harmonizuar mbi tokën evropjane të trungut të math europoid dhe kanë fituar, për këtë gjë, një fizionomi somatike e shpirtrore që i dallon shumë mirë nga trungje të tjera, përfaqsonsit e të cilave trungje kanë qënë dhe janë edhe sot të huaj për Evropjanët.” 12)

Auktorë të tjerë thonë se kemi të bëjmë me një përzjerje midis skajevet gjuhë e qytetrim dhe skajit racë, pse, si pas Boule-it nuk kemi aspak racë arjane, por vetëm gjuhë e qytetrim arjan. 13) Por çfardo drejtimi të marrin në t'arthmen këto mendime, për ne nuk ka asnjë rëndësi. Idiomës që flasim shtëpija e gjuhve indogjermane i a ka hapur të dy kanatat : traditat e bukura e bestytnit janë mbeturi të një qytetrimi që nuk na ndan nga popujt arjanë : studimet antropologjike racën tonë e mbajnë si një nga racat më të pastra e më të bukura t'Evropës me fizionomi somatike e shpirtrore që na përmbledh në gjirin e racës arjane, në kuptimin e matur e shkencor që i jep kësaj Biasutti.

11) Për t'u thelluar në këtë pikë, le të lexohet shkrimi i Guido LANDRA, “Cervello e Intelligenza”, botuar në Difesa della Razza, Viti VI, -Nr. 14, faqe 19-20.

12) BIASUTTI :. “Origine e sviluppo delle scienze. Antropologiche”, faqe 22.

Anthropologët skajet metiçiat e ibridizëm i përdorin praktikisht si sinonime. Do t'ishte ndofta m'i drejtë kuptimi i zooteknikvet: metiçiat është veprimi si mbas të cilit bashkohen metiçët 14) njëri me tjetrin dhe ibridizëm është "kryqzimi i dy specieveve" (Magne). Prodhimet e këtyre kryqzimeve thirren metiçë ose mulatër më rasjen e parë, ibridë në të dytën. Por le t'i përdorim edhe ne këto skaje pa bërë dallim.

Metiçë apo ibridë janë pra prodhimet e kryqzimit ndërmjet Negroidësh e Europoidësh ose në mes Mongoloidësh e Europoidësh. Por edhe nga bashkimi i një përfaqsonjsi të racës dinarike (Shqiptar, për shëmbull) me një përfaqsonjës të racës mesdhetare (Grek ose Sicilian) ose të racës nordike (Gjerman ose Ingliz) kemi pjellë të përbërë prej metiçësh; por në këtë rasje numri i karaktereveve somatike që bëjnë të dallohen këto raca prej shoqja shoqes është i kufizuar e prandaj ndryshimet midis prindërve e fëmijve nuk bjenë shumë në sy. Më shumë do të na tërhiqte vëmendjen prodhimi në mes të një Shqiptari (racë dinarike) e të një gabeleje (racë indide), mbassi midis këtyre dyve ka ndryshime të mëdha jo vetëm somatike, por edhe shpirtore.

Duhet lejuar apo jo kryqzimi midis dy racave të ndryshme, në mes të bardhëvet dhe njerzvet me lëkurë të ngjyerë ? Ka dy sisteme që bjenë në kundërshtim me shoqi shojnë : ai englez që e përjashton qoftë edhe në Hindin e banuar në pjesën më të madhe prej popujsh arjanë, të cilët me krijimin e kasteveve që përkojnë me racat tregojnë se e kanë në shpirt hierarkin racore; dhe ai frënk, spanjoll e portoges që e ka pranuar dhe e ka zbatuar këtë kryqzim.

Për këto kryqzime, ndofta, nuk do t'ishte folur kurrë sikur mos të besohej në hierarkin e racaveve njerzore.

13) Shif parathënjen e veprës së PITTARD-it "Les Races et l'histoire".

14) Metiçët janë pjella e kryqzimit të dy racave të ndryshme të një species.

Por a ka, me të vërtetë, raca superjore dhe raca inferjore ? Biologë të ndryshëm kanë thënë po ose jo pa u mbështetur më sprovime të mjafta shkencore. Pa u zgjatur në mëndimet e shprehura prej njërit ose tjetrit, na pëlqen të japim gjykimim e matur të Jennings-it: “Çështja e racavet superjore dhe e racavet inferjore, q’është rrahur kaq fort, e vënë në mënyrë gjenerike, nuk ka kuptim. Gjykime të sakta në këtë pikpamje nuk munt të jipen veçse në lidhje me një qëllim të caktuar ose me një aftësi të dalluar funksjonale.” 15)

Krahasimet e bëra në mes zezakvet dhe të bardhvet të Jamaikës prej Davenport e Steggerda vërtetojnë çka thot Auktori i sipërm. 16) Zezakët u kallxuan eprorë në provët e ndryshme që masin ndjeshmënin (sensibilitetin) muzikore, për shëmbull në dallimin e notavet, të tingujvet, të fuqis, të ritmevet të ndryshme. U çquan gjithashtu në zgjidhjen për mëndsh të problemeve të lehta arithmetike e në zbatimin e disa urdhrave të ngatrruar. Të bardhët, për kundrazi, dualën më t’aftë në kopjimin e figuravet gjeometrike të thjeshta, në vizatimin e trupit të njeriut pa pasur model, në rindërtimin e një kukulle të zbërthyer, në korrigjimin e frazavet të gabuara, në dhënjën e gjykimevet mbi çështje praktike.

Edhe studimet mbi metiçjatin njerzor në bazë të kriterivet gjenetike janë të pakta. Por gati të gjitha përfundojnë në një gjykim kundër metiçit, sidomos nga pikëpamja shpirtrore e morale. 17)

Cilsit shpirtrore dhe karakteret somatike të prodhimevet që dalin nga kryqëzimi i dy racavet qëndrojnë në rrugë të mesme. 18) Sikur, pra, të bashkohet përfaqsonjsi i një race te çquar për art me përfaqsonjsin e një race të çquar për trimëri, duhet të kemi përgjithësisht prodhime që nuk do të çquhen as n’art as në trimëri. Në grupet e Jamaikës metiçët u treguan, në përgjithsi, m’inferjorë qoftë nga të bardhët qoftë nga zezakët.

Aleksandër Ghigi ka studjuar gjat’ e gjërë në kafshë ibridizmin interspecifik, 19) do me thënë atë trajtë ibridizmi që l mbështetur në këto vërë e arsyttime dhe i pajosur me përvojën e gjatë të jetës që kalohet nëpër koloni, Frëngu P. Albert Perbal është shprehur përpara Kongresit Volta në shtator të vitit 1938 me këto fjalë: “metiçi është dënuar me turbullim shpirtor, është shkak prapsimi e shkatrimi, është një plagë n’evolucionin e natyrshëm.” 22)

15) H. S. JENNINGS : “Op. Cit.”, faqe 258.

16) Krahasimet mbi dy racat e ndryshme t’ishullit t’Antiljevet tërhoqën interesimin e të gjithë shkenctarvet, pse të dy grupet e vëzhguara kishin kushte të përngjarëshme kulturore dhe ekonomike dhe jetonin në rrethana të njëjta.

17) GHIGI : “Op. Cit.”, faqe 49.

18) BIASUTTI : “La classificazione delle razze umane viventi”, në Razze e popoli della Terra, faqe 292.

19) GHIGI : "Op. Cit.", faqe 49.

22) GHIGI : «Op. Cit.», faqe 53 - 54. Për të njohur më mirë problemin e përzierjes së racave, lexonjsi munt të shoh, përveç veprave të Ghigi-t e të Biasutti-t, edhe kapitullin e posaçëm të Jennings-it,, faqe 246-258 n' «Op. Cit.».

Raca, në kuptimin antropologjik, nuk ka asnjë lidhje me-kombin. Një popull me origjinë të njëjtë, me një histori të vetme, me gjuhë të përbashkët dhe me doke e zakone të përngjarëshme, trajton për bukuri një komb të vetëm, kurse munt të jetë i përbërë prej racash të ndryshme. Kjo ndoth me kombin italian, me kombin gjerman, me kombin grek, me kombin sërë. Vetëm për kombin shqiptar kemi një farë përjashtimi, por edhe ky, siç do të shohim, nuk përbëhet vetëm prej racës dinarike: një pjesë e Shqiptarvet, me gjithë se në përqindje shumë të vogël, është e tipit mesdhetar.

Por flitet rëndomë për një racë italjane, për një racë gjermane, për një racë shqiptare. Do t'ishte ndofta më drejtë të flitej për një trevë racore ose më mirë akoma për një komb italian, gjerman ose shqiptar. Me gjithë këtë edhe shprehja e parë e ka kuptimin e sajë shkencor. Këto raca eksistojnë me të vërtetë. Në trevat ku ato kanë zënë vënd ka një tip të caktuar që kalon prej një brezi në një bres tjetër. Kuptohet se një nga popujt e përmëndur nuk përbën një racë omogjene e të çquar mirë nga pikpamja biologjike, por disa nga elementet kryesore racore që përbëjnë grupin e europidëve hyjnë në setcilin ndër ta në përpjestime të ndryshme. Kështu për shëmbull, në popullin frënk kemi më tepër racën alpine me përqindje më të vogla nordikësh, mesdhetarësh e dinarikësh; në popullin gjerman ka sidomos nordikë e alpinë, një sasi më të vogël dinarikësh e ndonjë thërmijë mesdhetarësh e baltikësh; në popullin italian zënë vëndin e parë racat mesdhetare e dinarike, pastaj vjen raca alpine e më në funt ajo nordike.

Veçorit e këtij numri racash lëmohen, deri diku, nga kushtet. ambiente që kontribuojnë në krijimin e një fenotipi 23) të përbashkët. Nga ana tjetër, ambienti, me anën e veprimevet (pro-

cedimnitevet) selektive, ushtron ndikim te math edhe mbi dallimin e disa karakterevet të përbashkëta dhe mbi çdukjen e disa të tjeravet. Për dukjen e këtyre tipave të përbashkët të një kombi Keiserling-u me shumë të drejtë thot: «në qoftë se ka tipa kombëtarë, kjo rrjeth kurdoherë nga fakti se disa tipa të familjes kanë qenë më t'afte nga të tjerët për t'u fiksuar e për të përciellë (transmetuar) veçorit e tyre prej një brezi në brezin tjetër. Me fjalë të tjera një individ nuk është kurrsesi pinjoll i të gjithë stërgjyshërve të tij, sikurse thot gabimisht shumë kush, por vetëm i një numri të kufizuar të tyre.» 24)

23) Përmbledhja e veçorive somatike të një individi quhet fenotip.

24) BIASUTTI : "La classificazione ecc.", faqe 299

Në çdo mënyrë duhet pranuar se kombi është një e vërtetë antropologjike, jo vetëm si seli e një grumbulli të caktuar elementesh racore, por si seli e dalluar ku vërtetohen fenomene shkrirje (fuzionimi) e harmonizimi dhe si shtytës për lindje trajtash të reja (A. Keith). 25) Në këtë rasje nuk duhet të shikojmë vetëm veçorit morfologjike të një popullsije, por edhe veçorit fiziologjike e psiqike. Bilé, këto të funtmet kanë rëndësi më të madhe. Shëmbullin më të saktë na e japin Israelitët, ndër të cilët zotrimi i një numri notash psiqike bie në sy më tepër se sa frekuenca e vijavet somatike të përbashkëta.

Në krijimin e ndërgjegjes së racës e të ndërgjegjes kombëtare të përbashkët në një popull, rëndësin më të madhe e ka gjuha, e cila është ndër karakteret fiziologjike më të rëndësishme që ndan prerat njerin nga kafshët. Kjo është një element i dorës së parë që ndihmon për afrimin dhe përzjerjen e racave të ndryshme mbrënda një kombi. Shtetet e Bashkuara t' Amerikës janë një mozaik i vërtetë ethnic dhe, me gjithë këtë, kanë zhvilluar një ndjenjë të fortë kombëtare me anën e gjuhës. Edhe Meksiku është një vënt me racë kryesore indide e me shumë nën-raca; por ka fituar një kulturë latine e ndjenja të përbashkëta nëpër mjet të spanjishtes.

Kur kemi të bëjmë me nën-raca të një race të vetme, ose edhe me raca të ndryshme, por që nuk ndryshojnë shumë njëra prej tjetrës, gjuha bashkon. Duhet thënë veç, se kjo nuk ka fuqi të rrënojë muret e racës, atëherë kur ndryshimi bje tepër në sy në pamjen e jashtëme trupore, sidomos në ngjyrën e lëkurës dhe në gradën e zhvillimit të cilsivet morale, ça ka rëndësi të madhe për ruajtjen e pastërtis në një racë që jeton përzierë me një racë tjetër shumë të ndryshme. 26)

25) BIASUTTI : "La classificazione ecc.", faqe 300.

26) GHIGI : «Op. Cit.», faqe 36.

'Mbi origjinën e shqiptarëve (ilirëve)', A.Pulianós

Mbi origjinën e shqiptarëve (ilirëve)

Dëshiroj të falënderoj komitetin organizues për ftesën që më kanë bërë për të marrë pjesë në një Kuvend si ky. Organizimi i një takimi të tillë është një hap përpara në studimin e etnogjenezës së popujve të Ballkanit dhe, siç do të shpreheshin grekët, një hap për «të njohur vetveten». Deri disa dhjetëra vjet më parë etnogjeneza e popujve të Ballkanit studjohej kryesisht nga shkencëtarët joballkanas dhe problemet e etnogjenezës zgjidheshin para së gjithash mbi baza gjuhësore. Nuk merrej parasysh antropologjia fizike; po të flasim nga ana antropologjike, popuj si eskimezët ose australianët njiheshin më mirë se sa popujt e vendeve të Ballkanit. Antropologët e kishin drejtuar vështrimin nga vende më ekzotike. Tani ne vetë i kemi kthyer sytë nga oborri ynë dhe e shohim se ai nuk është më pak interesant se sa shumë vende të tjera. Çështja është që të mos i studiojmë popujt tanë vetëm nga një aspekt, por të marrim parasysh ndërthurjen e shumë shkencave. Etnogjenetika është një shkencë relativisht e re, e cila përveç gjuhësisë ndërthur së bashku arkeologjinë, etnografinë, historinë dhe antropologjinë fizike.

Kur antropologjia fizike filloi të japë më tepër të dhëna mbi gjenetikën e popujve, morën një goditje konceptet tradicionale mbi prejardhjen e popujve: lëvizjet e migrimit, të cilat mbaheshin si shkaktare të çfarëdo ndryshimi në jetën etnike të cilitdo popull, tani duhej të verifikoheshin nga të dhënat antropologjike. Kjo do të thotë që antropologjia fizike u përdor kryesisht si një burim historik. Duke përdorur të dhënat e antropologjisë fizike si një burim historik ne nisemi nga qëndrimi i padiskutueshëm, që veçoritë raciale në asnjë shkallë nuk përcaktojnë drejtimin e procesit historik, që tipi fizik në asnjë mënyrë nuk ndikon mbi formën dhe përmbajtjen e kulturës së cilitdo popull. Por mbi këtë bazë nuk mund të arrijmë në përfundimin, që tipi fizik i një populli nuk ka lidhje me historinë e tij. Përkundrazi formimi, përhapja dhe përzjerja e tipave fizikë janë rezultat i proceseve historike. Çdo ndryshim në trevën e përhapjes së njërit ose tjetrit tip, çdo ndryshim në përbërjen fizike të një popullsie, gjithmonë pasqyron migrimin dhe përzjerjen e fiseve e të popujve konkretë, d.m.th. proceset e historisë etnike.

Për shkak të faktit që karakteristikat fizike nuk kanë pasoja në zhvillimin e kulturës, tipi fizik i një popullsie të çdo territori të dhënë mund të ruhet për periudha të gjata, gjatë të cilave niveli i zhvillimit, aspekti kultural dhe madje gjuha e kësaj popullsie ndryshon deri sa bëhet e panjohur. Prandaj në një varg rastesh vetëm materiali antropologjik fizik mund të dëshmojë për praninë ose mungesën e migrameve në të kaluarën.

Duke gjurmuar përhapjen e tipave fizikë në përbërjen e grupeve të ndryshme etnike të sotme, duke i krahasuar ata (kur kemi në dorë material paleoantropologjik) me tipat fizikë të epokave të mëparshme dhe duke mbajtur parasysh rregullsitë gjatë kohës, antropologu shpesh jep përgjigje mjaft të përcaktuara për ato pyetje në historinë e një populli, të cilat janë të pafuqishme t'i japin disiplinat e tjera.

Tani për tani ne nuk kemi material skeletor nga trualli i Shqipërisë për të arritur në një përfundim, të paktën nga pikëpamja antropologjike, se cilët janë ilirët. Më lejoni t'u drejtohem arkeologëve të pranishëm këtu, që gjatë gërmimeve të mbledhin edhe copën më të vogël të kockave që gjejnë. Sot ka mjete kimike me ndihmën e të cilave ne mund të ruajmë e të mbledhim skelete të plota, kështu nuk lejojmë që të bëhen pluhur pasi nxirren prej varreve. Kam edhe një propozim tjetër. Për të bërë një shqyrtim antropologjik të plotë të popullsisë së gjallë të vendit të merren kampione, në marrëveshje me autoritetet, në pika të zgjedhura që nga veriu e deri në jug në moshat midis 20 e 60 vjeç për të dy sekset. Unë e di që janë bërë studime të tjera në të kaluarën por ato janë bërë në një shkallë të vogël dhe me metoda krejt të ndryshme. Sot ne kemi nevojë për një metodologji të njëzuar me vendet e tjera të Ballkanit. Të paktën kjo është bërë dhe ka ecur për mrekulli në Greqi e Bullgari, duke përfshirë vetëm pjesërisht e pak Turqinë e Jugosllavinë. Unë do të isha shumë i kënaqur nëse do të punoja në një komision të tillë antropologjik edhe në Shqipëri. Vetëm me një program të njëzuar ne mund të arrijmë brenda pak vjetësh në disa përfundime, se kush kanë qenë ilirët ose pellazgët, ose trakët.

~

Nga përvoja ime, duke studiuar antropologjinë e popujve të Ballkanit për afër dy dhjetëvjeçarë, unë kam arritur në këto përfundime, të cilat shkojnë edhe për truallin e Shqipërisë, meqë nëpërmjet projektimit, prekin edhe çështjen e origjinës së ilirëve:

1. Në Ballkan njeriu ka ekzistuar të paktën në 500.000 vjetët e fundit, në qoftë se jo më tepër. Është dëshmuar gjithashtu që këtu, në këtë tokë, është ndezur zjarri i parë në Evropë, sipas të dhënave të fundit. 1 Kështu prania e homo erectus në Ballkan na tregon që homo sapiens është formuar këtu, ai nuk ka ardhur nga jashtë. Prandaj treva e Ballkanit duhet të përfshihet këtej e tutje në zonën e hominizimit dhe nuk është e domosdoshme që ajo të kufizohet vetëm në tropikët.

2. Është dëshmuar, gjithashtu, që treva e Ballkanit është zona e kontaktit e dy tipave të mëdhenj raciale të europeidëve: e tipit «kontinental» vetë dhe e tipit të njohur mirë «mesdhetar». 2 Shqipëria nuk ka përse të ketë qenë një përjashtim. Vetëm se ne duhet të përcaktojmë kufijtë e këtyre dy tipave kryesorë në këtë territor, natyrisht duke marrë parasysh gjithë ndikimet e tjera në shtresimin e popullsisë, Vëzhgimi antropologjik i popullsisë të gjalla të Shqipërisë mund ta verifikojë këtë ose

mund të zbulojë elemente të rinj të panjohur deri më sot. Një gjë mund të thuhet që më parë, duke u mbështetur në të dhënat antropologjike të vendeve fqinjë, që masa kryesore e popullsisë së Shqipërisë është me origjinë autoktone që prej kohëve të hershme prehistorike.

Vetëm mbi këtë mbështetje, në sfondin e dy të dhënave të paraqitura më lart, ne mund ta studiojmë më në hollësi origjinën e shqiptarëve (ilirëve) dhe të shohim marrëdhëniet e popullsisë së vjetër e të re të Shqipërisë si edhe marrëdhëniet me popullsitë e tjera fqinje.

Termi «ilir» padyshim është një term indoevropian dhe përdoret vetëm gjuhësisht. A do të thotë kjo që trualli shqiptar nuk ka qenë i populluar para «ilirëve»? Ky do të ishte një absurditet shkencor dhe nuk mund të ketë ndonjë antropolog, i cili ta mbështesë këtë pikëpamje.

Të dhënat e fundit arkeologjike na tregojnë për një veprimtari njerëzore në truallin e Shqipërisë, të paktën që nga koha e neolitit. Sipas mendimit tim, përse u përket të dhënave antropologjike, duhet të gjenden tregues të paktën prej paleolitit të epërm. Edhe po të mos jetë e mundur kjo, kështu pa tjetër popullsia preilire ka banuar në këtë territor. Kështu kemi edhe një herë verifikimin e tezës së njohur mirë, që «gjuha dhe kultura janë të pavarura nga përhapja e tipave antropologjike, ndërsa përhapja e tipave antropologjike gjithmonë shoqërohet nga përhapja e gjuhës dhe e kulturës». (G. F. Debetz, 1952). Ka shumë të ngjarë, që indoevropaizimi i truallit shqiptar ka ndodhur si një proces shumë i ngadaltë nëpërmjet depërtimit të grupeve të tjera. Por lidhur me ilirët dhe shqiptarët e sotëm, kjo është një hipotezë që ka nevojë të vërtetohet me anë të të dhënave të antropologjisë fizike.

Vetëm kjo do të na nxjerrë nga kaosi indoevropian dhe joindoevropian.

1) A. N. Poulianos, Petralona - A middle pleistocene cave in Greece «Archaeology» v. 24, nr. 1 1971, f. 6-11.

2) A. N. Poulianos, The racial composition of the Balkan peoples. A-5 Anthropology of Races and Populations VIII. International Congress of Anthropological and Ethnological Sciences, Tokyo, 1968, f. 123-125.

Pulianósi paraqet interes në disa pikëpamje, por përpara duhet të dihet se puna e tij është luftu në heshtje që brenda akademisë greke. Pas disa gjetjeve «të çuditshme» hulumtimi iu ndërpre dhe iu uzurpua prej një grupi studiuesish amerikano-hebrej. Shkaku me sa u përfol më vonë dhe u pohua nga vetë studiuesi ishte fakti se rezultatet jo vetëm që nuk përputheshin me teorinë preafrikane të njeriut, por skeletet e gjetura në shpellën e Petralonës ishin me karakteristika race të bardhë në një rang kohor 500.000-700.000 vjet p.e.s. gjë që e hidhte krejt poshtë atë teori.

Kjo shpjegon dhe paraqitjen e tij në 1972 në Shqipëri në Kuvendin e Studimeve Ilire me atë ngut dhe ato kërkesa si më lart.

Pasi kaloi shpella në duart e ekipit të mësipërm, çfarë përmbahej në të u hesht dhe në vazhdim nuk u botua më asgjë. Gjithçka që la pas ky ekip i çuditshëm deri në ditët e sotme është një çështje gjyqësore mes Shoqërisë Antropologjike greke dhe bashkisë së zonës. Kjo pengon tashmë çdo studiues të interesuar për hulumtim, megjithëse shpella është kthyer në ekspozitë me disa gjetje të caktuara të reduktuara dhe të përshtatura. Sidoqoftë personi në fjalë kish nxjerrë përfundimet e veta, që përciptas i ka thënë dhe më lart. Për kë interesohet për atë periudhë nga ana antropologjike, duke qenë se ka lidhje të drejtpërdrejta me ne, duhet të gjurmohet patjetër rreth tij.

Por, thuaj se të gjithë antropologët kanë vëzhguar në popullin t'ënë tipare që provojnë se duhet të ketë, me doemos, kryqzime me raca të huaja. Krerët dolikoqefalë, syt e kaltërt e flokët e verdhë, që hasen aty këtu edhe ndër ne, nuk janë veçorira të racës dinarike. Lindin, pra, dyshime që duhen sqaruar. Spjegimin na e jep, deri diku, Marcello Boldrini. Ky, me gjithë se nuk e largon preras dyshimin e kryqzimevet, qoftë edhe shumë të kufizuara, me racat sllave, thotë se “kushtet gjeografike, faktorët ekonomikë, ndryshimet e përgjasimet antropologjike me popujt fqinjë, gjuha, zakonet përkrahin hipotezën e përzierjeve të vjetra që munt të kenë ndodhur edhe përpara vëndosjes së këtij populli në selin e sotëshme...” 24) Kush munt të thotë, atëherë, se Ilirët e lashtë, kur zunë vënt në Gadishullin ballkanik, nuk ishin, që të gjithë, të një tipi të vetëm fizik, por kishte midis tyre individë të pajosur me te gjitha tiparet që shihen edhe sot në popullin shqiptar ?

24) Marcello BOLDRINI : «Op. Cit.», faqe 44.

Tashi duhet bërë edhe një pyetje me rëndësi që ka lidhje vetëm me tregonjsin qefalik: kur përskrimet e vjetra dhe kafkat e të vdekurvet thonë se Ilirët kanë qënë kokë-gjatë, si munt të spjegohet brakioqefalija e fortë që vihet ré në Shqiptarët e sotshëm e, përgjithësisht, edhe në përfaqsonjsit e tjerë të racës dinarike? Anthropologët për shumë kohë janë orvatur t'a spjegojnë këtë fenomen. Kanë thënë në krye se, kur në disa varre, si për shëmbull në Glasinac, shihen ndër kohë të ndryshme kafka që kalojnë nga dolikoqefalija në brakioqefali, ka një popull kokë-shkurtër që vjen prej së largu dhe përzihet me vëndësit kokë-gjatë. Bile, pas një hipoteze të dytë — të dalë gjithnjë në kohën kur anthropologjija gjendej në shpërgënjt e foshnjëris — brakioqelalija kishte origjinë aziatike, domethënë ngastrat që popujt brakioqefalë zinin në kartën e Evropës ishin trevat ku popujt indo-gjermanë ishin përzierë me popujt jo të gjakut arjan t'ardhur prej kontinentit lindor. Por sot të dyja këto hipoteza janë rrëxuar prerat dhe prej të gjithë shkencëtarëvet është pranuar se popujt kokë-shkurtër kanë rrënjë kryekëput evropjane. 25) Anthropologët janë, gjithashtu, të mendimit — me gjithë që fenomeni nuk është spjeguar edhe — se në disa zona tregonjësi qefalik vjen duke u rritur; po kalohet pra vazhdimisht prej kafkave dolikoide në kafka brakoide pa patur përzjerje gjaku. Pittard-i këtë fenomen e ka vënë ré në komunën e Londrës dhe në krahinën e Savojës; 26) Biasutti thot se këtë shndërrim të trajtës së kokës nuk -duhet të lodhemi për t'a kërkuar ndër gërmime të banesavet të dikurshme të popujvet, pse sot, në shumë krahina t'Evropës, nga të cilat në disa lugina t'Alpeve, është e dokumentuar shtesa e brakioqefalis. 27)

Në kohën kur Franz Bopp-i dhe shkolla e tij bënin krahasime ndërmjet gjuhësh të ndryshme për të zbuluar në to karakterin hindo-gjerman, një studjonjësi i math engles, Max Mueller-i, shkruante se popujt që flitnin gjuhë të një rrënje, kishin edhe besime që i përngjanin mjaft njëri tjetrit. 28) Theorija e tij qe luftuar prej shumë kuj për një kohë të gjatë, por më vonë u kuptua se lufta qe e pavënt. 29) U pranua gati nga të tërë mithologët se në themel teorija e Max Mueller-it ishte e drejtë e prandaj, edhe një herë nisën kërkimet në këtë drejtim.

Është pohuar prej të gjithvet se baza e mithologjis arjane është besimi i diellit. Ky besim, si ndër popuj të tjerë të lashtë me gjuhë arjane ashtu edhe ndër Ilirët, qe në pah të math dhe, për çudi, pjesë të tij kanë mbetur gjallë gjer në ditët t'ona në popullin shqiptar.

Disa vjetë më parë u zbulua n'Austri kryeqyteti i krahinës Noricum që banohej prej Ilirësh.30) Thirrej Noreia dhe gjëndeje në malin Lugenboden. Ndër sa ndërtesa të tjera u zbulua edhe pallati mbretor dhe, jo shumë lark këtij, një tempull i goditur në të tretin shekull p.e.s.. Ky tempull është i rrumbullakët, 31) me tetë metra diametër dhe i rrethuar me një postrehë, pullazi i së cilës mbahej, si duket, me shtylla të drunjtja. Në mes ishte altari, i përbërë prej katër rrasash të të mëdha e të rënda, të latuara e të ngritura mbi tokë. Ndën altar ndodhej vatra e zjarmit për flit që truheshin. Ndonjë statujë Perëndije nuk u gjet në këtë vënt të shënjtë, pse besimi i Ilirvet ishte pa ikona. Por mënyra e ndërtimit të kujton me një herë tempujt e vjetër të Romës ku nderohej dielli. Në majë të një kodre që gjëndet pranë katundit Igls në malsi të Tirolit, Zonja Miltner ka zbuluar një tempull tjetër ilir, në mes të të cilit u gjet shtrirë një rras' e madhe që përbënte altarin. 32) Në mëngjes, kur dielli dilte për të parën herë në buzë të malit, rrezet e tij binin mu në mes t'altarit duke-kaluar nëpër një gallustër të

hapur, për këtë qëllim, në pullas. Që kjo ndërtesë është faltore nuk duhet të kemi asnjë dyshim; varret rreth - e - rrotull sajë vërtetojnë se, një soj si sot, edhe Ilirvet të moçëm i u pëlqente t'i varrosnin të dashurit e tyre afër tokës së bekuar.

25) Renato BIASUTTI : «La classificazione delle Razze Umane», faqe 276 e 301.

26) PITTARD : «Les Races et histoire», faqe 19, 28, 29 e tutje.

27) BIASUTTI : «L'Umanita attuale», faqe 229, 230.

28) J. EVOLA : «Il Mito del sangue», faqe 9.

29) Raffaele PETTAZZONI : (Accademico d'Italia) : «Antichi culti nella penisola balcanica», Rivista d'Albania, 1941, faqe 109.

30) GELASIUS : «Bindimi i Diellit ndër Ilirët», Hylli i Dritës, 1913, faqe 77.

32) GELASIUS : «Op. Cit.» faqe 80.

Ndër popujt e tjerë të vjetër që banonin në Ballkan, kulti i diellit ka qënë shumë i përhapur. 33) Ky kult as nuk ka qënë i njohur në kohën greke arkaike e klasike me përjashtim të Helios-it në Rodi; por edhe për këtë dyshohet se mos ka origjinë të huaj. Një filozof platonik, Maksimi prej Tiros, tregon se fisi ilir i Peonvet adhuronte diellin në trajtë të pafytyrzuar të një disku të vogël të lartësuar mbi një shkop të gjatë. Në monedhat e mbretit Lykkeios të Peonis, që qe aleat i Ilirvet të tjerë e i Thrakasvet kundër Mbretit të Maqedhonis, shihet dëndur koka e Apollit stolisur me dafina; ky ka qënë perëndi që përfytyronte diellin.

Edhe Thrakasit që, si ç'thamë, janë të njëj gjaku e gjuhe me Ilirët, e adhuronin diellin. Sofokliu, në tragjedin e çdukur Tereus, vë këto fjalë në gojën e Thrakasit Orfé: "O Diell hyll shumë i nderuar prej Thrakasvet, miq të kuajve." Në një tragjedi tjetër t'Eskilit, Bassaridet, Orfeu squhet që me natë për t'u ngjitur përpara agimit në majën e malit Pangeo që t'i falej Diellit, i cili për të ishte Perëndija m'e madhe.

Nuk ka shënja të shumta t'adhurimit të diellit anikonik nga ana e Thrakasvet. Por provohet mirë besimi i tyre ndaj Apollit, të cilit shumë herë i ngjiten mbiemra vendës, si për shëmbull Sitalkas, ashtu si ç'janë thirrur shumë nga princat e vëndit, dhe Zerynthois që përfaqson emrin e një fisi të tyre. Fytyra e “kalorsit thrakas” ka zakonisht rreth kokës një kurorë rrezesh, shënj' e qartë kjo që vërteton lidhjen shpirtrore të popullit me diellin

33) Mbi adhurimin e diellit ndër Ilirë, Thrakas e Maqedhonas, shif PETTAZZONI, «Op. Cit.»

Të përmëdim, me qënë se ra rasja, edhe një legjendë maqedhonase, mbassi edhe populli që polli Lekën e Math është, si pas mendimit të shumicës së historjanvet, i një origjine me Ilirët. Perdika, themelonjsi i shtëpis mbretnore të Maqedhonis, ishte m'i vogli i tre vllazërve të cilët, nga toka e Iliris, kishin shkuar në Lebaia dhe ishin marrë në shërbim si barinj' prej mbretit të vëndit. Kur mbretresha mbrunte bukët, kishte vënë ré se kurdoherë buka e Perdikës bymehej dy herë më shumë nga bukët e tjera. I a kallxon këtë gjë Mbretit dhe ky, i trëmbur prej këtij farë paralajmërimi, i dëbon të tre vllazrit. Ata kërkojnë rrogën q'u qe caktuar, por mbreti nuk u a jep. Veç, u tregon këtyreve diellin që n'atë çast po hynte në shtëpi nga një bir' e pullazit, dhe u thotë: “kjo është rroga që ju meritoni.” Dhe ja ku Perdika përgjigjet në këmbë e në dorë: “edhe ne e pranojmë” dhe, me një thikë që kishte me vehte, shkroi mbi tokë rrethin e diellit. Pastaj hyri tri herë mbrënda këtij dielli të vizatuar për dhé e u largua bashkë me të vllazrit. Vepra me karakter magjik dha përfundimin e pritur, pse Perdika, kur pushtoi të gjithë Maqedhonin, u bë edhe zot i Lebaia-s. Legjenda dëshmon hapët se edhe ndër Maqedhonas dielli adhurohej.

Ndërsa ky adhurim i diellit tregon me saktësi vulën arjane që mbante populli ilir dhe popujt q'ishin të njëj gjaku me të, traditat e mbetura gjer më sot ndër Shqiptarë flasin hapet mbi origjinën ilire të popullit t'onë.

Populli i malevet dhe i fushavet beson edhe sot me këmbëngulje në diellin. Njëzet shekuj krishterimi e myslimanizmi nuk kanë mundur t'i a çrrënjosin këtë besim. Ai vazhdon të hetohet për diell e për rreze të tij. Një varg bestytnish (supersticjonesh) e lidhin me të. Në folklorin t'onë gjënden pjesë të shumta këngësh në të cilat kreshnikët flasin me diellin si të flisnin me një vehtje të gjallë, i kërkojnë atij të mira dhe i binden.

Por ka edhe më. D. Nikollë Gazulli na tregon se Ilirët kishin për simbol të diellit kryqin me grepça, atë që kanë pasur edhe të gjithë popujt arjanë dhe që përfaqson zjarmin, flakën e gjallë. 34) Ky simbol,

na siguron Autori, është i njohur edhe sot ndër malsit e Snkodrës. Shumë gra e qëndisin kryqin me grepça ndër xhubleta të tyre. Në hetimet që ai ka bërë duke pyetur ato që mirren me këto qëndima, ka nxënë se ky trashgim u ka mbetur prej plakash të moçme.

34) GELASIUS: (pseudonimi i D. Nikollë Gazullit) «Op. Cit.» faqe 83 - 84. Kryqi me grepça mbahet si emblema e Pantheonit arjan dhe e qytetimit arjan. Gjermanët e sotshëm e kanë vënë atë në flamurin kombëtar për të kallxuar lidhjen e ngushtë shpirtrore të lëvizjes së tvre me traditat e mbetura trashgim prej stërgjyshërve.

Tashi të përmbledhim mendimet mbi origjinën e racës shqiptare.

Pamë në këto faqe se Ilirët janë popull me gjak e gjuhë indo-gjermane dhe se Shqiptarët janë bijt e tyre të vëndosur në krahinat e sotshme që nga kohët më të lashta.

Nga theorit e ndryshme linguistike, shkencëtarët po përkrahin më shumë atë që thotë se gjuha shqipe është një gjuhë thrakoilire dhe, duke qënë se po provohet se Thrakas e Ilir janë dy degë të një ethnos-i të vetëm, duhet pranuar mendimi i Ribezzo-s, si pas të cilit Shqiptarët e sotshëm janë pasardhësit e Ilirvet.

Kërkimet arkeologjike na vijnë në ndihmë pikërisht atje ku lajmet historike mungojnë dhe provat gjuhësore nuk kanë fuqi. Është një periudhë kur karta etnografike e Ballkanit është përzier shumë, pse popuj të ndryshëm aziatikë janë dyndur mbi tokët e Gadishullit dhe popujt anas (autoktonë) kanë qenë të detyruar të ndryshojnë vënt. Zbulimet e tumuleve të Komanit dhe ato të Afionës japin lëndë të mjaftë për të vërtetuar vazhdimin e elementit etnik që nga shkatrimi i Perandoris së Romës gjer në shekullin e tetë e.s.. Pas kësaj kohe historia nuk flet më për migrim fisesh të huaja në tokën e banuar prej Shqiptarvet.

Anthropologët nuk kanë lëndë të mjaftuarshme skeletrike për të vëndosur se Shqiptarë e Ilirë janë një racë e vetme. As kronikanët e vjetër nuk përshkruajnë gjë me saktësi. Por nga studimet e bëra mbi Shqiptarët e sotshëm provohet se këta janë të një race të vetme që thirret dinarike ose ilirike dhe kanë afrim vetëm me ata popuj që janë vëndosur në vise ku historikisht provohet se ka një nënshtresë të dëndur Ilirësh.

Më në funt, nga mithologjia nxjerrim gjith ato prova për të vërtetuar se të parët t'anë ishin arjanë dhe se Shqiptarët e sotshëm ruajnë edhe sot shumë besime në lidhje me diellin. Këto bestytini na kanë mbetur trashgim nga besimet e Ilirvet.

“Shqiptarvet të soçëm, thot Arturo Galanti, i u përshtatet, emri neo-ilir, pors Grekvet të rinj ai i neo-helenvet dhe Italjanvet, Frëngjvet, Spanjolvjet, Portogezvet e Rumunvet emri neo-latin”. 35) Krahasimi i Auktorit italian mbështetet më fortë në gjuhë e qytetrim se sa në gjak. Shqiptarët janë stërnipët e drejtë-për-drejtë t'Ilirvet, jo vetëm pse rrënja e gjuhës së tyre është ilire dhe se qytetrimi i vërtetë i tyre mban shumë elemente të qytetimit të këtij populli, por më tepër pse në venat e tyre lëviz po ai gjak që dikur i u jipte jetë e gjallëri Ilirvet të lashtë.

35) Arturo GALANTI : “Populli Shqiptar”, në Bota Shqiptare, 1943, faqe 117.

IV. RACA SHQIPTARE NËPËR SHEKUJ

NDIKIMET NË GJAK DHE NDIKIMET NË GJUHË E QYTETRIM - KOLONIT GREKE DHE PUSHTIMI ROMAK - DYNDJET E SËRBVET E TË BULLGARVET - DIASPORA E PARË SHQIPTARE - MYSLIMANIZMI DHE RACA - SHQIPTARËT NE KOSOVË - SHQIPTARËT E MËDHENJ.

Të flaç për origjinën e largët të një populli evropian, nuk ke thënë kurrgjë për racën e tij, pse dyndjet e shumta të popujvet që kanë mbushur faqet e historis së mesme e të ré, që nga shkatrimi i Romës gjer në ditët t'ona, kanë lënë, pa dyshim, gjurmë të pashlyershme në kartën ethnografike të këtij kontinenti. Shumë popuj, dikur krejt të pastër për racë, sot janë ndryshuar kaq fort, sa që munt të thuhet se në venat e tyre qarkullon çdo lloj gjaku tjetër përveç atij të fisit q'i u ka lënë emrin ose, ndonjë herë, gjuhën. Shëmbullin më të gjallë na e japin Grekët e sotshëm. Thezin e shpallur nga Fallmerayer-i e përkrahin edhe antropologët: shumë pak gjak i u ka mbetur fqinjvet t'anë të jugës nga Elenët e moçëm. Gjuha e Omerit mbulon me mantelin e sajë një tok Shqiptarësh e Sllavësh t'ardhur në Gadishullin elenik gjatë sundimit bizantin q' i a ka ndryshuar krejt vijat morfologjike dhe veçorit psiqike popullit vëndës.

Po ajo vëré munt të bëhet edhe për pjesën më të madhe t'ilirvet të vjetër. Fiset e tyre, të shumta në numër, ishin përhapur që përtej Danubit — Baviera, Austrija e Hungarija banoreshin prej tyre 1) — gjer në gjirin e Ambracis dhe një vijë që ndjek afër e ngjat kufirin e paraluftës midis Jugosllavis e Rumanis dhe Jugosllavis e Bullgaris i ndante, nga ana e lindjes, me popujt fqinjë q'ishin, edhe këta, të një gjaku me ta. Mbrënda këtij trekëndshi kaq të math, sot zë vënt një grumbull popujsh të ndryshëm: Gjermanë, Kroatë, Sërbë, Malazias, Bosnjakë e Hercegovinas, Bullgarë, Shqiptarë e Vllehë, pa përmëndur grupet e tjera më të vogla që janë

infiltruar më me pakicë. Për të kuptuar si kanë ndodhur këto shtrajttime ethnike, duhen përmëndur pa tjetër lëvizjet e fisevet të ndryshme që janë sjellë ndër këto vise e që kanë lënë në racë gjurmë të pashlyershme.

Edhe kur një popull, si Ilirët, zë vënt në një trevë të caktuar dhe heth rrënjë ndër viset më të përshtatëshme për banesë, nuk siguron pastërtin e gjakut për sa kohë popuj të tjerë, për arsye imperializmi ose pse vazhdojnë jetën endacake, hidhen në trevën e tij dhe ose e pushtojnë ushtarakisht ose depërtohen (infiltrohen) në të. Këta, në çdo rasje, i a turbullojnë pak a shumë qytetrimin dhe i a përziejnë gjakun. J. Brunhes, në veprën e tij *La Géographie de l'Histoire* i dallon lëvizjet e popujve «në lëvizje që ndryshojnë karakterin e racave pse veprojnë në turma të mëdha (racial drift) e në lëvizje që ndryshojnë vetëm qytetrimin e tyre (cultural drift), pse të riardhurit nuk bëjnë gjë tjetër veçse depërtohen, treten në popullsin e më parëshme të vëndit ; por edhe depërtimi (infiltrimi) nuk kalon pa lënë ndonjë ndikim në racë 2)».

1) Karl PATSCH : «Ilirët», përkthyer prej Karl Gurakuqit, Tiranë, 1923, faqe 5.

2) Henri BERR : në Parathënje të veprës «Les Races et l'Histoire», faqe 13.

Mendimi i këtij Auktori i përngjan, me gjithë se nuk përputhet, edhe përfundimit në të cilin arrin Pittard-i. Anthropologu zviceran mendon se shumë rrallë ndohej që një popull t'i japë veçorit e veta fizike një populli tjetër që pushton. Pikërisht këtë thonë edhe Gini, Martial-i e Genna. I pari flet mbi qëndresën e pamposhtur të veçorive antropologjike të popujvet të sunduar për ball ndikimevet të popujvet sundonjës ; i dyti thot se metiçët e lindur nga kryqzimet e Galvet me Romakët i humbën dalje-ngadalë shënjat e romanizimit për shkak të kryqzimevet të mëvonëshme me elementin vëndës ; i treti përmënt se si depërtimet e Asirvet të vjetër ndër Ebrej nuk kanë numdur të ndryshojnë përbërjen etnike të këtyreve të fundit, me gjithë se të dy këta popuj i përkisnin trungut semit 3).

Popujt që kanë patur të bëjnë me Ilirët gjatë shekujve kanë qënë kolonizatorë, pushtonjës ushtarakë ose migrantë endacakë. Këta nuk kanë patur kontakt të barabartë me të gjithë turmën ilirike të përhapur në një trevë kaq të madhe. Por, ndërsa ndrydhja e tyre ka qënë m'e fortë për disa fise e vise, ka qënë shumë m'e dobët ose nuk është ndier aspak ndër fise e vise të tjera. Disa nga këta popuj nuk kanë lënë gjurmë veçse në qytetrim; kurse disa të tjerë kanë lënë

shumë gjak ndër viset e pushtuara. "Vetëm ai grup i Ilirvet që më vonë u çqua me emrin Shqiptar, qëndroi m'i pastërti dhe, me gjithë se e ndjeu mjaft ndikesën e qytetimit të huaj, mbeti gati krejt i paprekur për nga raca.

Por, për të kuptuar këtë të vërtetë, duhet të hyjmë pak në histori e të flasim, në vija të përgjithëshme, mbi trajtën e përpjekjevet që Ilirët e moçëm e Shqiptarët e mëvonshëm patën me të huaj.

3) Shif mbi këtë argument: MARRO : «Op. Cit.», faqe 39 e tutje.

Në jugë të viseve që banoreshin prej të parvet t'anë qëndronte një popull shumë m'i qytetruar e m'i organizuar se ata. Grekët kishin zënë vënt në një tokë të varfër. Për të jetuar në nivelin q'i u impononte qytetrimi, kishin nevojë për të shfrytëzuar vise më të pasura të banuara prej popujsh që ata i thirrnin barbarë. Kishin, për ato kohë, një industri të përparuar dhe, mbi të gjitha, një tregti shumë të zhvilluar. I u shisnin «barbarvet» mallra të fabrikuar në qytetet e tyre të shkëlqyera ose të blerë ndër vise të tjera të Mesdheut dhe i u mirrinin ç'u duhej për të jetuar: drith, metale të çëmuarshme e çdo pasuri tjetër. Deti Mesdhë ishte qarkuar prej kollonive të tyre të lulzuara. Edhe në Bregun lindor t'Adriatikut, Grekët themeluan një vark qytetesh midis së cilave çquhen Buthroton, Phoinikon, Apollonia, Dyrrachion, Nymphaion e Lissus.

Ndikimi helen ndër këto vise është ndier më fort në kulturë. Në besim e gjuhë ka lënë vrraga të lehta. Por kudo, në një sipërfaqe të kufizuar. Në veri nuk langohej shumë prej rretheve të kollonis, ndërsa në jugë, hinterlandi shtrihej diçka më tepër. Përveç skelave të bregdetit, në mes t'Apollonis e të Butrintos kemi edhe disa qëndra të tjera greke, sidomos në Mallakastër, që shërbenin si tregje ku,

midis vendësvet e t'ardhurvet shkëmbeheshin prodhime bujqësore me lëndë industriale. Kultura q'u përhap në këto vise ishte greke. Por harti grek, diku diku merr trajta të posaçme që kanë lindur nga shpirti krijonjës i vëndit. Shëmbull: kapitelet e stilit apolloniat të zbuluara në Pojan nga Kryetari i Misjonit frëng Léon Rey. Por, sidoqoftë, mbetemi në fushën e kulturës. Përzjerje gjaku nuk ka pasur aspak, ose ka pasur aq shumë pak sa që nuk vlen as të zihet me gojë.

Me pushtimin romak ndikesa e huaj bëhet shumë m'e fortë. Passi Mbreti i funtmë i Ilirvet, Genci, thyhet, zihet rop (në vitin 168 p.e.s.) dhe dërgohet në Romë për të stolitur karrocën triumfore të Pretorit Lucius Anicius, të gjitha tokët e Mbretis së tij e të fisevet të tjera bjenë dal-e-ngadalë në dorë t'ushtris së fortë të Qytetit të shiat kodravet. Populli ngadhnjmtar nuk është vetëm i fuqishëm ushtarakisht, por qëndron edhe shumë përpara në qytetrim. Ndikimi i tij, në krye i kufizuar, u përhap në të katër anët e tokës ilire, por nuk e romanizoi krejtësisht popullin që banonte në të.

Ky ndikim nuk qe i barabartë në të gjitha viset ; diku u ndie shumë më tepër e diku shumë më pak. Drejtimet e tij përputhen me ato q'u ndoqën nga legjionet ushtarake. Ndjekin pra rrugët e detit e ato të tokës që topografikisht nuk pengojnë kalimin. Në vija të përgjithëshme presioni romak u ndie më tepër në bregdetin dalmatin, rreth e rrotull rrugës Egnatia që shkonte nga Apollonia e Durrsi deri në Salonik dhe në luginën e Danubit. Në këtë të funtmen, sidomos, presjoni ka qënë shumë m'i fortë, pse legjionet e Romës kishin zënë vënt me shumicë jo aq për të siguruar arterjet më të rëndësishme të lëvizjes së tyre nga sulmet e vendësvet, se sa për të penguar, në një vark fortifikimesh, — q'u shtuan shumë më tepër në kohën e Justinianit e të perandorvet të tjerë të Bizancit — çdo mësymje të papritur të popujve nomadë e gjysëm t'egjër që vinin prej veriut e prej veri-lindjes. Kemi pra disa pjesë të tokës ilire shumë të ndikuara e disa të tjera, posaçërisht viset malore ose të varfra ekonomikisht ose ato q'u ndodhën lark këtyre rrugëve jetike për Romën, gati të paprekura.

Qytetrimi i Romës la gjurmë të pashlyershme në çdo sektor të jetës. Gjuha pësoi më fortë se të gjitha. Në shumë vise ilirishtja nuk u fol më dhe vëndin e sajë e zuri latinishtja. «Sikur të zgjaste edhe ca kohë ky zhvillim, thot Stadtmüller-i, atëherë gjuha e herëshme shqipe mbrënda një ose dy shekujve do t'i ishte shtrure krejtësisht romanizimit dhe Shqiptarët e sotshëm do të flitshin një dialekt romak qi do t'ishte shumë i afërm me gjuhën rumune 4).»

Por, ndërsa qytetrimi e gjuha e ushtarvet të Romës u përhap ku më shumë e ku më pak në të gjithë Ilirin, asnjë historjan nuk flet për depërtim gjaku latin. Studimet antropologjike, nga ana tjetër, e provojnë, siç do të shohim, këtë pastërti. Legjionet e Romës nuk patën kontakte të shumta me popullsin vëndëse. Nga viset e Ballkanit, vetëm në Dacje 5), e pra shumë lark prej tokës shqiptare, thot

3) Shif mbi këtë argument: MARRO : «Op. Cit.», faqe 39 e tutje.

4) STADTMUELLER : «Op. Cit.», në Hylli i Dritës 1942, faqe 150.

historija, u themelua një koloni romane e shumtë në numër, por edhe kjo duhet të jetë larguar q'andëj më 271 e.s., në kohën e Aureljanit, atëherë kur kërcënimi i Gotvet e kishte bërë të vështirë qëndrimin e sajë.

Nga ana tjetër, sundimi romak ka qënë shumë i butë me popujt e nënshtruar që nuk i qitnin ngatrrësa. Ja ç'shkruan Patsch-i për të: «Romanët në luftë qenë t'egjër, e shtroshin pa farë dhimbe çdo kryengritje. Por përkundrazi, kur sipëranija e tyre njihej e nderohej, atëherë i u jipshin të nënshtruemvet një liri shumë të gjanë. Ata nuk u përkitshin në kombësin (mendo racën) e tyre, as në besim, as në kulturën qi kishin; edhe n'administratë i lijsin të lirë, për sa u jipshin leje interesat e Mbretnia, Ata nuk kërkoshin prej të nënshtruemve qi të shkriheshin e t'asimiloheshin me ta; por asht e dijtun se pushtimi prej një populli të fortë, të dijtun e të përparuem, linte me doemos gjurmët e veta në popullin e mundun. Prej kësaj pune kuptohet lehtazi, qi të nënshtruemit, porsa shihnin se rifitimi i vetqeverimit të tyre nuk ishte i mundun, i shtroheshin gjëndjes së re, përparojshin, por tue ruejtë vetit kombtare 5)... »

Dhe duhet t'ishte pikërisht kështu. Ndryshe nuk ka si të spjegohet fakti që gati dy qint vjetë pas pushtimit nga Roma, fiset ilire e kishin akoma të ndezur ndjenjën e liris dhe, shumë ndër to, të prira nga Desetiatët e të komanduara nga Bato-ja, nisën kundër Romakve luftën për shkundjen e robëris, luftë kjo që zgjati plot tre vjetë (deri më 9 e.s.) dhe pati episoda të shkëlqyershëm trimërije 6)

Gjatë sundimit të Perandoris bizantine, popuj të shumtë racash të ndryshme i turren tokëvet të pasura të Gadishullit, i drejtohen shumë herë Kostantinopolit dhe e ndryshojnë kryekëput kartën ethnike të visevet ku shkelin. Shumë nga këta kalojnë nëpër krahinat ilire, por kalim meteorësh: vrasin, plaçkitin, pa lënë asnjë trragë tjetër. Kështu ndoth me Gotët, me Hunët, me Antët, me Hungarët, me Avarët 7).

Të huaj qenë edhe Venecjanët, Amalfitanët e Raguzanët që mbajtën shumë koloni në bregun e Adriatikut, por as përpjekjet me këta popuj nuk kanë ndonjë rëndësi, pse krijuan vetëm marëdhënje tregtare e jo lidhje gjaku. Nga këta, Venecjanët kanë pasur edhe një farë sipëranije politike ndër disa krahina afër detit. Më vonë Normanët e Angjevinët krijuan mbretrira që mbetën më këmbë për shumë vjetë; por kemi të bëjmë gjithnjë me sundime politike e ushtarake e jo me migracione popujsh të tërë që munt të ndryshojnë gjakun e vëndasvet me të cilët përzihen.

5) Karl PATSCH : «Ilirët», faqe 41 - 42.

6) PATSCH : «Ilirët», faqe 36, 37, 38.

7) PITTARD : në veprën e cituar «Lee Races et l'Histoire» faqe 15 përmënt rasjen e Vizigotve që mbrënda tridhjet e nënt vjetësh bëjnë qindra lëvizje në Ballkan, n'Itali e në Spanjë. Është e natyrshme pyetja : Ç'farë ndikese racore munt të kenë pasur ata ndër viset që shkelën?

Dy rreziqe i janë kërcënuar racës shqiptare gjatë sundimit bizantin: ai i greqizmit dhe ai i sllavizmit. Ndërsa i pari do të ndihej vetëm në gjuhë e në kulturë, i dyti do t'ishte me të vërtetë rrezik për çdukjen ose përzierjen e fortë të gjakut e prandaj do të kishte për rrjedhim shuarjen e njësis racore shqiptare në Ballkan.

Një farë ndikese të helenizmit e ndjeu populli i ynë porsa Perandorija e Lindjes u nda nga ajo e Perëndimit. Thuaj se e gjithë toka e Ilirvet mbeti nën Bizantinët e prej tyre mori pjesërisht fën orthodoxe dhe pësoi n'organizimin shoqëror, ekonomik e familjar mbresa të forta që kanë mbetur të pashlyera gjer në ditët e sotëshme. Sikur kjo Perandori t'ishte ushtarakisht m'e fuqishme, me kulturën e sajë të zhvilluar, me ligjët e përsosura dhe me administratën e mënçme kishte për t'a greqizuar shumë shpejt vëndin t'onë, por ngatrrerat e mbrëndëshme dhe luftrat e jashtëme e penguan një veprim të këtille. Nga kjo pikpamje krijimi i Perandoris latine të Bizancit në Kryqëzatën e katërt e, bashkë me këtë, forcimi i auktoritetit të Dogëvet dhe sundimi i Normanvet e i Angjevinvet kanë qënë një farë kundërpeshë e nevojshme 8). Por pengimin më të math helenizimit i a solli dyndja e Sllavëvet, do me thënë e Serbëvet dhe e Bullgarëvet, në Ballkan. Kjo çduku një rrezik, por ngjalli një rrezik tjetër shumë më të math.

Sërbët ishin bujqë e druarë 9) dhe prandaj të pazotë për luftë. Përhapjen dhe fitimet e tyre u a detyrojnë Avarvet prej gjaku turk që dikur, si fise ushtarake kalorse, shkonin jetë nomade në krahinë e Panonis. U dukën në tokën bizantine në kohën e mbretrimit të çquar të Justinianit, por, me gjithë se në fillim nuk patën sukses pse fuqija e monarkut ilirjan ishte e madhe, nuk shkoi kohë që të bëhen element i rrezikshëm për Perandorin. Shkelën në dy valë viset e Iliris. Vala e parë nuk ka asnjë rëndësi, pse mësymjet bëhen në grupe të vogla dhe jo prej njësisish politike t'organizuara. Qëllimi i këtyre lëvizjeve nuk qe që të kërkonin banesa të reja, por që të bënin plaçkë; pas çdo mësymje ata ktheheshin rishtas përtej Danubit ku kishin banesën e zakonëshme.

Vala e dytë qe shumë m'e rreptë. Të bashkuar me Avarët, ata më 578 shkretuan Thrakën, Ilirin e vise të tjera dhe u hodhën gjer në Greqi 10). Selaniku u mësyte për të parën herë prej tyre.

8) N. JORGA : «Brève Histoire de l'Albanie et du Peuple Albanais», Bucarest, 1919, faqe 18.

9) STADTMUELLER : «Op. Cit.», Hylli i Dritës, 1942, faqe 150.

10) V. N. ZLATARSKI : «Die Besiedelung der Balkanhalbinsel durch die Slaven», në Revue Int. Et. Balk., 1938, faqe 361 e tutje

Jehona e pushtimevet të këtyre fiseve barbare u përhap shpejt në të gjithë Perandorin, pra deri në vise të largëta t'Azis e t'Afrikës. Duket se në disa luftëra këta kanë bashkëpunuar edhe me fise ilire. Peshkopi egjyptian i Nikiu-s shkruante aso here në këtë mënyrë: «Në lidhje me Perandorin romane ka lajme se mbretit e kësaj kohe, bashkë me Barbarët, me popuj të huaj e me Ilirjanë, rrënojnë qytetet kristjane dhe marrin banonjsit robër. Vetëm qyteti i Salonikut ka mundur të shpëtojë pse i ka muret e forta dhe, për hir të mbrojtjes së Zotit, popujt e huaj nuk kanë mundur t'a marrin ; por i gjithë populli i krahinës ka dalë fare 11)».

Kuptohet nga kjo kronikë se munt të ketë pasur një farë bashkëpunimi midis Sërbve dhe një pjese Ilirjanësh ndër vjetët e parë t'ardhjes së tyre në Ballkan ose, të paktën, ordhit sllave nuk duhet të jenë pritur keq prej Ilirvet në krahinat e të cilëvevëv zunë vënt. E kjo duhet t'i ketë sjellë dobi të madhe praktike popullit vëndas: ndalimin e çfarosjes ose të largimit të tij nga toka ku banonte që prej shekujsh. Por, sidoqoftë, kurrgjë nuk i pengonte Sërbët që të shtriheshin sa nga veri-perndimi aq nga lindja. Disa nga fiset e tyre pushtuan bregdetin dalmatin, tokët që sot thirren Sloveni e Kroaci dhe arrijtën në veri gjer sa u takuan me popujt gjermanë e me Hungarezët. Në këtë trevë të gjërë ata u përzien me Ilirët e i u dhanë këtyreve gjuhën. Të tjera fise u përhapën në tokën që përbën Sërbën e sotëshme, në Bosnje, Hercegovinë, Mal të Zi e u shtytën deri n'Alpet Shqiptare.

Kjo pjesë e dytë ka për ne rëndësi shumë më të madhe pse, ndërsa e para zuri vënt nëpër treva të cilat që prej kohësh ishin romanizuar, kjo, me lëvizjet e herë-pas-herëshme ka qënë një kërcënim i vazhduarshëm për atë grup t'Ilirvet që më vonë u thirrën Arbër.

Rëndësi më të madhe nga Sërbët për Shqipërin e pa-romanizuar të shekujvet XI, XII, XIII kanë Bullgarët. Këta, kur shkelën për të parën herë në Ballkan t'udhëhequr nga Asparuchi dhe u vëndosën në Dobrukhën e sotëshme, ishin të pakët në numër, por luftarë të zotë e prandaj shumë të rrezikshëm për Perandorin e Bizancit. Nga kontakti që patën me Sllavët, të cilët n'atë kohë ishin përhapur në jugë të Danubit, u sllavizuan e u shtuan tepër, pse në rreshtat e tyre hyri edhe shumë element sërb. Muarën pra gjuhën e tyre, fën kristjane dhe, sidomos, gjakun sllav. Nxunë, gjithashtu, mjeshtrinë kryesore të Sërbvet, bujqësin.

Në takimet që këta Bullgarë të sllavizuar patën me Shqiptarët, prej shekullit të shtatë deri në shekullin e dhjetë, jetuan në paq 12). Në tre shekujt e pastajshëm kemi periudhën perandorake bullgare. Të prirë prej Perandorit të tyre Simeon i Math, këta luftojnë kundër Bizancit, e thyejnë në shumë anë ; i u shpallin luftë Sërbvet, i mposhtin edhe këta. Më 917 Shqipërija e jugës, Epiri me kryeqytetin e tij Nikopolis, dhe një pjesë e Shqipërisë së mesme bjenë në duart e tyre.

11) VASILIEV: "Op. Cit." tome I, faqe 223, 224.

12) STADTMUELLER : «Op. Cit», Hylli i Dritës, 1942, faqe 158.

Qëndrimi i Bullgarëve në Shqipëri ka lënë shumë fjalë në gjuhë e, sidomos, shumë emra në toponomastikë. Munt të linte edhe shumë gjak e munt t'i sllavizonte krejtë krahinat jugore sikur Perandorija bizantine të mos ishte fuqizuar pas një shekulli nën skeptrin e perandorvet maqedhonas. Nga këta, Vasili i dytë, Bullgaroktoni, e sulmoi Carin Samuel disa herë, shkaktrroi ushtrinë e tij të fortë dhe, më 1018, i dha përkohësisht funt fuqis së madhe që pat krijuar Simeoni. Mbretria bullgare, kaq e rrezikëshme për racën t'onë, u bë copë e thërrime dhe vëndin e sajë e zuri Perandorija bizantine, sundimi i së cilës kishte më tepër karakter administrativ. Për administrimin e viseve shqiptare u krijuan thema e Dyrracchium-it, me Durrsin si kryevënt.

Por disa familje bullgare duhet të kenë mbetur në Shqipëri edhe pas shkatrrimit t'organizatës së fortë politiko-ushtarake. Ndikesa e këtyre elementeve të mbetura, e mbajtur gjallë prej Patriarkatit t'Ohrit që ndodhej mu në zëmër të Shqipëris, u përtërit edhe një herë me rilindjen e Perandoris bullgare nën Ivan Asenin e parë. Për fat kjo periudhë perandorake e dytë nuk zgjati për shumë kohë, pse, me vdekjen e Asenit të dytë (1241), fuqija e tij, që munt të krahasohej me atë të Carit të parë, u çduk me një herë nga luftrat e mbëndëshme dhe, bashkë me të, edhe ndikesa bullgare në Shqipëri mori funt.

Në këtë kohë eksistenca e një Shqipërije kombëtare, «e një toke të banuar vetëm prej kësaj race», nuk munt të vihet në dyshim. Kur Ivan Aseni, Car i Bullgarve, ai që do t'i jepte funt Despotatit t'Epinit, fal një privilegj tregtije, e vëndos krahinën e Devollit në «tokën e Arbanases.» Mbishkrimi i mirënjohur i Tërnovos, në të cilin Sovrani bullgar numron të gjitha pronat e tij, shënon edhe një «tokë e Arbanases» pranë një «toke greke» ... Barinjtë shqiptarë, një soj si barinjtë e famshëm vllahë, përmenden nga gjysma e shekullit të XIII.» 13)

Me shekullin e XIV-të fillon të bëhet fjalë edhe një herë për Sërbët. Këta nisën t'organizohen politikisht e ushtarakisht. Mbretria e themeluar prej Stefan Nemanjës zgjati thuajse një shekull dhe, nën Stefan Dushanin, u zgjerua kaq shumë sa përmbloodhi në gjirin e sajë, përveç Sërbisë së Vjetër, edhe të gjithë Shqipërinë me kufijtë etnikë të sotshëm, Greqinë, Maqedhoninë e një pjesë të Thracisë. Stefan Dushani vetë, ditën e pashkëve të vitit 1346, u kurorëzua «perandor i Sërbëve, Shqiptarëve, Bullgarëve dhe Grekëve» prej patriarkut sërb të Shkupit në prani të patriarkut bullgar t'Ohrit, të kryeigumenit të Malit të Shënjtë e të shumë peshkopve të tjerë, të mbledhur nga të gjitha viset e Mbretërisë së tij të gjërë dhe po përgatitej për t'i rënë Kostantinopolit 14). Por vdekja e tij e papritur (1355) shkaktoi edhe vdekjen e rrezikut sllav për Bizancin dhe për vëndin t'onë. Princat e vogjël u shpallën me një herë më vehte dhe prenë çdo marëdhënje me Sërbët. Tyrqit, më në funt, i dhanë shkelmin e vdekjes organizimit të Car Dushanit kur, në luftën e Kosovës (1389), vranë krajinën e tyre të funtëm, Lazarin.

13) JORGA : «Brève Histoire de l'Albanie etc.», faqe 21, 22.

14) Në vënt që t'i nënshtronte, Perandori Sërb u mundua më shumë që të bëhej mik i Shqiptarvet e prandaj jo vetëm u suall mjaft mirë, por edhe futi shumë ndër ta n'ushtrin e tij të madhe. «Venetikasi i quanin ushtarët e Gjeneralit të tij Perljubi, që hyri gjer në kështjellin e Pteleonës, me emrin Albanenses». Dr. Milan SYFFLAY : «Sërbët dhe Shqiptarët», Tiranë, 1926, faqe 113.

Kur Sllavët shkelën ndër viset ilire, gjetën atje këto popullsira: në veri të Danubit, Gjermanë; në disa koloni bregdetase, Grekë; në të gjithë pjesën veriore të Ballkanit, prej Adriatikut gjer në kufi të Dakjes, Ilirë të romanizuar e disa Romakë; ndër disa vise malore e të varfra që nuk përshkoheshin prej rrugësh të rëndësishme, Ilirë të pastër nga gjaku që vetëm në gjuhë e në qytetrim kishin ndjerë pak a shumë ndikimin latin. Ordhit e reja barbare e detyrojnë popullsin e vjetër të romanizuar e të greqizuar të viseve të mbrëndëshme të Ballkanit që t'ikij e të vëndoset në qytetet e bregut t'Adriatikut e nëpër ishujt e detit ku qëndroi nën mbrojtjen e flotës bizantine 15). Një numër i vogël shkoi në male ku pjesërisht u shqiptarizua, pjesërisht u sllavizua. Një pjesë tjetër — dhe kjo duhet të jetë m'e madhja — pranoi të bashkëjetojë me pushtonjsit e të ndjekë lëvizjet e tyre ushtarake dhe dal' e ngadalë e humbi gjuhën e vetë. Ekzistenca e Morlakvet si njësi ethnike e dalluar mirë deri në shekullin e XVII-të, tregon se disa nga Ilirët e romanizuar kaluan ndër male 16).

Në këtë mënyrë krahinat e gjëra që dikur banoheshin prej Ilirësh, që nga Danubi e gjer në rrëzë t'Alpeve Shqiptare dhe që nga bregdeti dalmatin e gjer në viset më të skajëshme të lindjes, sllavizohen të gjitha. Ka midis këtyreve ishuj që e kanë mbajtur të pastër gjakun shqiptar dhe të paprekur gjuhën gjer në shekullin e XIV-të 17); por edhe këta ishuj me kohë asimilohen.

Studimet anthropologjike vërtetojnë qartas se në trajtimin racor të popullit sllav të jugës ka shumë gjak ilir 18). Bilé, munt të thuhet se e gjithë pjesa perndimore e Gadishullit ilirik që përmbledh Kroatët, Dalmatinët, Bosnjakët, Malazezët,

Shqiptarët dhe gjysmën e Grekvet është e popullzuar prej fisesh që kanë të gjitha tiparet e racës ilirike e prandaj përbëjnë së bashku një unitet ethnic të çquar mirë. Kartat e botuara prej Pittard-it në Les Peuples des Balkans flasin qartas për këtë të vërtetë.

15) STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 151.

16) SUFFLAY : «Op. Cit.», faqe 107 e 117. Gjika BOBICH : «I discendenti degli Illiri, i Morlacchi», Difesa della Bazza. Anno III, 5 - 20 Shtator 1940, Nr. 21 - 22

17) «Për rranzë të detit, Shqiptarët në kohën e mesme mrrijshin në veri ma larg se sot. Degët e trupit shqiptar të premuna nga kolonizimi sloven i zhupanvet të vjetër ndërmjet Ulqinit, Budues e liqenit të Shkodrës, shiheshin në të 13-tin e të 14-tin qindvjet për qark të Raguzës e të Kotorrit...» SUFFLAY: «Op. Cit.», faqe 109.

18) Pittard-it, q'është një nga njohsit më të mirë të kushteve anthropologjike të Balkanit, i është mbushur mendja se pjesa m'e madhe e popullsive balkanike me gjuhë sllavishte nuk i përket trungut të vjetër sllav, por është e sllavizuar. Jugosllavët shkruan ai, përbëjnë një shëmbull interesant të gabimeve që shkaktohen nga konceptet gjuhësore. Shif B. BATTAGLIA : «Op. Cit.», faqe 763.

Hapsira ku shtrihet raca shqiptare pas vërshimeve sllave është pra shumë e kufizuar: përfshin disa malsira të Shqipërisë së sotëshme. Si pas Stadtmüller-it vetëm krahinën e Matit 19). Por thezi i albanologut të ri gjerman, që ka hasur në kundërshime të shumta, nuk duhet t'i përshtatet shumë së vërtetës. Po të jetë siç thot ai, ku u gjeten qindra mijrat e Shqiptarvet q'u shpërndanë, duke nisur prej të XI-it shekull, në të gjithë Greqinë perndimore e jugore, në viset e Vardarit e të Kosovës e, më vonë, pas luftave me Tyrqit, edhe n'Itali? Por t'a lëmë më nj'anë këtë çështje. Është punë historianësh dhe linguistësh të zotë për t'a shoshitur thezin e Stadtmüller-it.

Duhet pranuar veç, se sipërfaqja toksore ku shtrihet raca shqiptare ishte shumë e kufizuar gjër në shekullin e njëmbëdhjetë, do me thënë deri në shkatërrimin e Perandorisë së parë bullgare të themeluar nga Cari Simeon.

Pas tatëpjetës së kësaj fuqije fillon zgjerimi i hapsirës jetsore të Shqiptarvet, më parë në fusha e kodrina të Shqipërisë së mesme e jugore prej nga dëbohen ose nënshtrohen pronarët e bujqit sllavë 20); më pas në vise më të largëta drejt Greqisë. Lajmin më të parë të migracionit shqiptar në gadishullin elenik e kemi nga vjetët 1021-1022 21).

Me ardhjen në fuqi të një serie perandorësh të zotë në Bizanc, migracioni jashtë kufijve toksorë të Shqipërisë ndërpritet, por kolonizimi i mbrëndshëm vijon. Tokët pjellore nisin të banohen e të punohen prej vetë Shqiptarëve. «Nëpër malet shqiptare, të paprekuna nga lufta e rreziqet, popullsija e një race shumë të bukur u mbajtë e freskët, pjellore, e shëndoshë, me një jetësi të jashtëzakonëshme ndër disa vise, e qëndrueshme ndër të gjitha fatkeqsit, luftare... Ai element bredhës filloi me u rrotulluem prej maleve ndër fusha i lodhun prej luftave të pandame e prej rreziqevet të të papushueme 22).»

19) STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 153.

20) STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 218.

21) Jean G. KERSOPOULOS : «Chronologie Albanaise», Extrait de la revue «Les Balkans», Athènes, 1937, faqe 20.

22) SUFFLAY : «Op. Cit.», faqe 111.

Në fund të shekullit XIII nis vala më e madhe e përhapjes së fiseve shqiptare përjashta tokës së vet duke ndjekur dy rrugë: drejt veri-lindjes vëndosen në Kosovë, Rashë, Sërbi, në një pjesë të madhe të Maqedhonis verjore e perndimore; drejt jugës ngulen në Thesali, Epir, Etoli e Akarnani 23). Shumë nga këta braktisin tokët e porsa-hapura të Myzeqës e të Savrës për të shkuar në viset e largëta të Gadishullit helenik 24). Diku janë të ftuar prej vetë pronarvet të tokëvet që kishin mbetur djerrë 25) ; diku thërriten prej despotvet bizantinë të vëndit të cilët kanë nevojë për fuqira ushtarake që të mbrohen kundër Tyrqvet 26) ; diku shkojnë vetë në fise t'organizuara ushtarakisht e t'udhëhequra prej princërvet të tyre 27) ose të huaj 28).

N'atë kohë në Greqi zjente një shpirt kolonizimi një soj si n'Itali n'epokën e kolonizimit të math të Gjermanvet 29). Shkaku duhet kërkuar në rrallimin e fortë të popullsis greko-sllave t'atëhershme prej lufttravet të dëndura e sidomos prej murtajës së zezë të vitit 1346 e cila u përhap nga thellsit e Azis në Greqin e jugës dhe shkaktoi vdekje të panumërta 30).

Shqiptarët që shkuan në Gadishullin helenik u shpërndanë pjesërisht në Thesali e pjesërisht në krahinat perndimore. Ata të Thesalis përmenden që në kohën e Andronikut të tretë (1328-1341) si pronarë të mëdhaj tokësh (arhondër) 31). Me shkeljen e Stefan Dushanit në këtë krahinë, arhondët dhe stratiotët grekë u dëbuan prej çifliqeve të veta dhe vëndin e tyre e zunë, më të shumtën, kryetarët shqiptarë e prandaj numri i tyre u shtua më tepër 32).

Nga Epiri, Etolija e Akarnanija, me kohë u larguan disa Shqiptarë të ndarë në dy degë: njëra degë shkoi në Beoti. Atikë, Negropont dhe n'ishujt e tjerë të detit Egjë. Pjesa tjetër, e ftuar prej Despotit të Mistrës, Manuel Kantakuzenit, kalon gjirin e Korinthit dhe vëndoset në Moré (1383) 33). Ftesa përsëritet nga Despoti i mëpastajshëm Theodor Paleologu dhe numri i familjevet shqiptare shtohet akoma më tepër 34).

Shqiptarët ishin trima e puntorë e prandaj, me fuqin e pushkës dhe me punën e tyre të parreshtur, i suallën dobira të mëdha vëndit. Perandori Manuel i dytë, thot Vasiliev-i, në fjalimin e varrimit që mbajti për Despotin që solli Shqiptarët, e lavdëron atë shumë për këtë masë me vënt 35).

Në këtë mënyrë Shqiptarët u përhapën me shumicë në të gjithë Greqin. Në Moré, kaq i math qe numri i tyre, sa që një shkrimtar e diplomat i kohës, Gjergj Phrantzae, si me lot për faqe, ankon se në kohë të tij, në gjysmën e shekullit të pesmëdhjetë, dy të tretat e Gadishullit ishin shqiptare me 290 mij vetë e me 30 mij luftarë 36).

23) STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 218.

- 24) SUFFLAY : «Op. Cit.», faqe 111.
- 25) STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 219.
- 26) KERSOPOULOS : «Op. Cit.», faqe 26 dhe VASILIEV : «Op. Cit.», tome II, faqe 327.
- 27) Duhet përmëndur këta priesa : Bua Shpata, Pjetër Losha, Gjinj Bua Shpata. KERSOPOULOS : «Chronologie», faqe 26, 27.
- 28) SUFFLAY : «Op. Cit.», faqe 114.
- 29) STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 218.
- 30) VASILIEV : «Op. Cit.», Tome II, faqe 311 - 312. Kjo epidemi shkaktoi vdekjen e shumë vetve. Viktimat e saj n'Evropë e n'Azia kapen në 48 milionë. Shumë historjanë bizantinë, ndër të cilët Jean Kantakuzeni, kanë bërë përshkrime të hollësishme mbi këtë murtajë.
- 31) VASILIEV : «Op. Cit.», Tome II, faqe 393.
- 32) SUFFLAY : «Op. Cit.», faqe 113, 114.
- 33) «Bota Shqiptare», faqe 603 dhe KERSOPOULOS ; «Op. Cit.», faqe 27.
- 34) VASILIEV : «Op. Cit.», Tome II, faqe 327.
- 35) VASILIEV : «Op. Cit.», Tome II, faqe 327.
- 36) «Bota Shqiptare», faqe 603, 604.

Me dukjen e parë të Tyrqvet ndër tokët t'ona, krijohet edhe një rrugë e ré shpërngulje për Shqiptarët; shumë familje shkojnë n'Itali, në Raguzë, Venetik, Rekanatë e Ankonë, por nuk trajtojnë kolonira të caktuara. Këto kolonira themelohen më vonë në Pulje, Kalabri, e Siqeli, kur rreziku tyrk shtohet e sidomos atëherë kur Heroi i ynë kombëtar ndrron jetë dhe ushtrit e pathyershme të Sulltanit pushtojnë me radhë të gjitha kështjellat e forta dhe qytetet e lulëzuara.

Gennaro M. Monti shkruan: « pushteti i Tyrqvet më shumë se një sundim i vërtetë qe një sovranitet i lartë 37).» Ka pasur karakter administrativ e ushtarak e prandaj nuk do të kishte rëndësi të madhe për historin e racës s'onë, sikur herë pas here mos të kishin dalë njerz që gjejnë halën në përpeq e të kishin thënë se tyrqizmi ka lënë gjurmë të pashlyershme, se e ka ndryshuar gati krejt gjakun arjan e se ka çrrënjësuar cilsit ario-evropjane nga populli shqiptar.

-
- 37) «Albania», Guida della Consociazione Turistica Italiana, Cenna Storico, faqe 49.

Akuza është e vjetër; dhe, me gjithë se është përgënjeshtuar disa herë, prap, kur ndokush ka pasur interes, është përsëritur. Këtë mendim pa vënt këta njerz e mbështesin në myslimanizmin që u përhap në tri të katërtat e popullit shqiptar. A ka ndonjë farë themeli ky besim? Asnjë. Pse myslimanizëm nuk do të thotë tyrqizëm, sado që, pas pushtimit t'Egjyptit prej Tyrqvet, përfaqsonjsi i Muhamedit në tokë ishte një kryetar shteti, vetë Sulltani i Osmanllinjvet. Të besojmë sa shkruajnë këta të huaj të përciptë ose dashakeqë, do t'ishte një soj sikur të pohojmë se Gjermanët ndrruan gjak, pse lanë paganizmin dhe përçafuan krishterimin ose se Englezët e sotshëm nuk janë më ata të pesqint vjetve më parë, pse u ndanë nga Kisha Katholike Apostollore Romane.

Duhet të pranohej sa thonë këta, sikur myslimanizmi të përhapej me anën e turmave kolone tyrke të vëndosura prej Portës së Lartë ndër krahina të ndryshme të Shqipëris. Por një kolonizim të këtillë nuk e përmënt asnjë herë historija. Ettore Rossi, kur mirret me përhapjen e fes së Pejgamberit pohon: «nuk munt të thuhet se islamizmi i Shqipëris ka qënë i ndihmuar prej imigrimit t'elementeve tyrke. Sulltanët shpërndanë disa fise t'Anadollit nëpër Ballkan, por nuk i shtyjtën këto gjer në Shqipëri 38).»

Një misjonar, Fr. Angelo da Bergamo, i cili pat vizituar vëndin t'onë që në gjysmën e parë të gjashtqindshit. « pat vënë ré se Shqiptarët muhamedanë ishin gati të gjithë të lindur në vënt dhe se zbrisnin nga Kristjanët që kishin ndrruar fé 39). »

Gjithë këtë thot preras një i ditur pollak që studjon shpërndarjen e elementeve të racës tyrke në Ballkan: «me gjithë se Islami është shumë i përhapur në Shqipëri, nuk ka aglomeratë tyrke të rëndsishtme në kët vënt 40).»

Kështu flet edhe arsyja. Sikur familje Osmanllinjsh ose Tartarësh të nguleshin në tokën t'onë, si këto do t'i humbisnin zakonet e gjuhën e tyre duke patur kontakt të vazhduarshëm me sundonjsit e një gjaku? Në Rumani ku sipëranija tyrke ka qënë shumë m'e dobët se në Shqipëri, pse atje kurdoherë janë mbajtur një farë autonomije dhe një princ kristjan në krye, shohim edhe sot se Gagauzët, Qyrdët, Lipovanët, Tartarët e Tyrqit, të vëndosur në Dobrukhë që prej kohësh, i kanë ruajtur dhe i ruajnë edhe ndër ditët t'ona gjuhën, fé, zakonet dhe tiparet e racës nga e kanë origjinën.

38) Ettore ROSST : «Saggio sul dominio turco e l'introduzione dell'Islam in Albania», në Rivista d'Albania, Viti III, fashikull IV, faqe 206.

39) Fernanda GRANATA : «L'Albania « le Missioni italiane nella prima meta del secolo XVII in base a documenti inediti», në Rivista d'Albania, Viti III, fashikull IV, faqe 231 e 234.

40) Tadeusz KOWALSKI : «Les Turcs Balkaniques», në Revue Internationale des Etudes Balkaniques, II année, tome 3-4, faqe 423.

Duhet shtuar, më në funt, se nuk do t'ishte n'asnjë mënyrë e mundur që një popull me gjak të përzier e gati tyrk të ruajë për pesë shekuj ndjenjën e individualitetit kombëtar dhe të mos trëmbet as nga mallkimet e Babi Alis, por të kërkojë e të fitojë mvehtësin politike.

Por prap — munt të thotë ndokush — edhe në mos qoftë e ardhur prej s'di se ku pjesa m'e madhe e myslimanvet, lihet për të dyshuar shumë në karakterin e, pikërisht, në racën (pse karakteri është funksjon i racës) e një populli që si pa të keq shqelmon fé'n e vetë për të pranuar një fé që s'ka asnjë lidhje me të parën. Këtu, mendon një studjonjës i problemeve shqiptare që mbahet si m'i thelli njohës i shpirtit t'onë, ka të bëjë një farë «forma mentis etiko-psikologjike paqëndrese që është diktuar kurdoherë në tokën ilirike dhe që ka ngasje të rrjedhë nga coptimi politik nën të cilin qenë shtruar thuaj se pa prerë popullsit q'e banuan 41).»

Të njëjtin mendim e ka pas çfaqur me kohë Dr. Vladan Gjorgjeviçi. Ai e tha më rrumbullakët : Shqiptarët ndjekin një parim filozofik të çuditëshëm si pas të cilit « e kuj të jetë shpata e atij do të jetë edhe besa 42).»

41) P. Fulvio CORDIGNANO : «L'Albania nella Storia e nella Vita», në Rivista d'Albania, Viti II, fashikull I, faqe 39.

42) Dr. Vladan DJORDJEVIÇ : «Shqiptarët e Fuqit e Mëdha», përkthimi i Mustafa Krujës, Zara, 1928, faqe 41.

A është e vërtetë kjo akuzë? Aspak.

Është e vërtetë vetëm se Shqiptari nuk është i lidhur shumë ngushtë me fé. Se Shqiptari, me të gjitha valët e qytetimit të huaj që ka kaluar, ka mbetur prap se prap, në funt të shpirtit, pagan e se beson më me qejf në çukën e shkëmbënjtë të Tomorrit ose në guvën e thellë të Sarisalltëkut mbi Krujë, se sa në shënjtin më çuditëbërës, qoftë ky i myslimanvet, qoftë i kristjanvet; se trëmbet më shumë nga shitimi i Orëvet e i Zanavet se sa nga shpata e mprehtë e Kryeengjellit Mëhill q'i u merr jetën njerzve. Kur paganizmi është rrënjosur kaq shumë në shpirtin e një populli, që s'është zhytur akoma kok' e këmbë në pellgun e qytetimit evropjan, atij i duket se fé't e tjera mundet t'i ndryshojë më me lehtësi, pse këto nuk i a çrrënjosin bestytnit me të cilat ai ka lidhur ngushtë botëkuptimin e tij, jetën e tij familjare e shoqërore.

Por, as kjo nuk është arsya kryesore e përhapjes së myslimanizmit në Shqipëri. Arsya e vërtetë duhet kërkuar në faktorët historikë e shoqërorë. Le t'i gërmojmë pak këta faktorë — veç sipërfaqësisht, pse mbi shkaqet dhe mënyrën e përhapjes së myslimanizmit në vëndin t'onë është shkruar shumë pak dhe gjysmakërisht.

Pas vdekjes së herojit t'onë kombëtar, Skënderbeut, ushtrit e mëdha të Sulltanit pushtuan me radhë te gjithë kështjellat që përfaqsonin fuqin e zogjvet të shqipes: Berat, Krujë, Drishtin, Leshin, Shkodrën e më në fund Durrsin e Vlorën. Princat e priesat shqiptarë e kuptuan se i u kërcënohej jeta, nderi e besimi e prandaj u shpërngulën duke marrë me vehte të gjithë klasën që përfaqsonte bujarin e vëndit e, sidomos, klerin kristjan, pse pikërisht ky e ndjente vehten më fort në rrezik nën sundimin e Gjysëmshënës. Në tokën e Kastriotit mbetet atëherë populli m'i ulët (bujqit e barijt) e m'i pakulturë. Krye për t'a drejtuar, për t'a mbajtur të bashkuar e për t'i treguar rrugën e detyrës nuk ka. Ça do të thotë shumë, pse porsa është kaluar kufiri i Mesjetës së mbushur me feudalizmin karakteristik e me frymën kristjane fanatike të krijuar nga një numër tepër i ngjeshur priftrinjs.

Për t'i u përshtatur rymës së re që po i a ndryshon dukien lëndore e shpirtore të gjithë Evropës dhe, pastaj, për të gjetur rrugën më të drejtë që duhet ndjekur në vëndin e tij të pushtuar nga një popull krejt i huaj jo vetëm për gjak e gjuhë, por edhe për konceptin që ka për këtë e për atë jetë, Shqiptarët i duhen udhëheqës shpirtërorë shumë të zotë. Këta i mungojnë kryekëput e prandaj ky mbetet i hutuar në mes të katër rrugëve. Gati të gjithë krerët e Shqipëris që luftuan krah për krah me Skënderbënin nuk qëndruan në mes të tij për t'i treguar udhën. Shumë të pakët qenë ata priftrinjt që pranuan rreziqet e rënda q'i u kërcënoheshin për të shpëtuar shpirtrat e vllëzërvet që s'munt të kapërcenin detin. Miqsija e Gjergj Kastriotit me Mbretin e Napolit dhe politika venecjane e muarën më qafë krishterimin shqiptar.

Dokumentat historikë e provojnë katërçipërisht mungesën e priesave politikë e shpirtërorë. Të gjitha relacionet e shekujvet të XVI-të e të XVII-të q'i janë dërguar Vatikanit thonë se në Shqipëri nuk ka meshtarë e se ndonjë që këtu këtë mund të ketë mbetur, është kaq ignorant sa që memzi lexon Ungjillin 43). Shumë vise vetëm një herë në dhjetë vjetë e shikonin me sy barin e shpirtravet e, edhe kur kishin fatin të dëgjonin një meshë, nuk gjenin dot te prifti njerin e përshtatshëm që do t'i jipte dorën për t'a nxjerrë nga balta të mjerin që kishte ngecur në llomin e mëkateve e të dyshimit 44). «Më 1642, thot Sufflay, ishin në Shqipëri të veriut priftën të rij pa asnjë cilsi: ushtarët që në Lombardi kishin nuanë italishten, konkurroshin me përfundim të mirë për priftënj 45).» Shumë kush lindte e vdiste pa parë meshtar me sy. Arkivat e huaja na dëftojnë gjithë ato rasje kur dinjitarë të dioqezeve katolike të Shqipëris e kalonin jetën në Zara, në Venetik ose në Romë pa shkelur asnjë herë në tokën e juridikcionit të tyre fetar 46).

43) ROSSI : «Op. Cit.», faqe 207.

44) GRANATA : «Op. Cit.», faqe 227, 228, 229.

45) SUFFLAY : «Op. Cit.», faqe 93.

46) Giuseppe PRAGA : «I Vescovado albanese nel sec. XVI», Rivista d'Albania, 1940, faqe 142. - GRANATA : «Op. Cit.», faqe 228 e tutje. - SUFFLAY: «Op. Cit.», faqe 149, 150.

Ç'ndoth ndër katholicë, pasqyrohet edhe në botën orthodoxe shqiptare. Më sa në veri, dua të themë në krahinat e patriarkatit të Pejës, kjo në fillim nuk pëson humbje të mëdha — pse kleri sllav kishte mbetur i gjithë në vënt edhe pas shkeljes së Tyrqve në Sërbi — bilé, herë herë e përhap juridikcionin e sajë edhe në botën katholike të mbetur pa priftrinjtë 47), në jugë punët shkojnë shumë keq. Nga dokumentat e vlefshëm që na sjell At Nilo Borgia në historin misjonare I Monaci Basitiani d'Italia in Albania provohet se kleri orthodox i jugës ishte për faqe të zezë e se peshkopët nuk ushtronin ndonjë veprimtari fetare, por interesoheshin më shumë për t'u marrë me intriga të kota ose për të mbledhur t'ardhurat e dioqezeve të tyre 48).

Më shumë se një herë ngjan që katunde të tëra, me prift e peshkop në krye, të lënë fën orthodoxe dhe të bëhen myslimane 49).

Punët ndryshojnë vetëm atëherë kur Austro-Ungaria 50) dhe Rusia 51) i marrin nën sjetull kristjanët e Ballkanit. Por për kristjanët e Shqipëris kjo mbrojtje ishte shumë e vonë. Pjesa e tyre m'e madhe kishte kaluar në myslimanizëm një qint vjetë më parë 52).

Kjo është suaza e saktë e gjëndjes shpirtrore e fetare në Shqipëri në mbarimin e shekullit të gjashtëmbëdhjetë. Ç'munt të bëjnë Shqiptarët kaq pak t' organizuar shpirtërisht kundër rebeshit aziatik? Ndjenja e auto-konservacionit, që është një nga karakteristikat kryesore të racës së tyre, i mëson që të mënjanojnë, të braktisin jetën e qetë të qëndrimit urbane ose begatin e fushavet pjellore dhe t'arratisen nëpër male. Disa misjonarë të huaj që kanë shkelur nëpër këto anë i kanë parë këta Shqiptarë dhe i kanë përshkruar si njerz t'egjër që jetojnë nëpër shpella 53). Në këtë mënyrë munt të qëndronin më shumë në fën e Krishtit. Por kataklizma shpirtrore i ka tronditur. Disa faktorë të tjerë, ekstrinsekë që ndërhyjnë në këtë kohë, e shpejtësojnë islamizimin.

47) GRANATA : «Op. Cit.», faqe 229, par. II dhe faqe 243, par. II. - Shif edhe SUFFLAY : «Op. Cit.», faqe 110.

48) Shif në «Studi Albanesi» volumet III - IV e V - VI dhe «I Monaci Basiliani d'Italia in Albania», Periodo secondo,- Roma, botim i Reale Accademia d'Italia, 1942.

49) ROSSI : «Op. Cit.», faqe 207 dhe Z. M. : «Peja në kohën e Luftës ballkanike», në Hylli i Dritës, vjeti XVI, faqe 344.

50) ...në virtyt të traktateve të Karlovitz-it (1699), të Passarovitz-it (1718) e të Belgradit (1739) që lidhi me Tyrqin, mori përsipër mbrojtjen e katholicëve shqiptarë .

51) Mori në mbrojtje të gjithë Orthodoxët e Ballkanit. Shif edhe Mehdi FRASHRI : «Op. Cit.», faqe 38.

52) ROSSI : n'«Op. Cit.», faqe 207, thot se nga viti 1620 gjer më 1650, treqmtmij Shqiptarë u hënë myslimanë.

Tyrqit kanë nevojë t'a shtrojnë këtë popull për dy arsye: më parë, që të mos u qesë pengime kur ushtrit e tyre të mëdha do të kalojnë nëpër Shqipëri për të mposhtur vise të tjera të Ballkanit që ngrenë krye ose për t'u hedhur në Gadishullin e Apeninëve; pastaj, që t'a shfrytzojnë trimërin e tij të pashoqe duke e përdorur si shokë armësh. Që të mirren vesht me të duhet të krijojnë më parë një klasë drejtonjse, e cila ndër një qint vjetët e parë të sundimit osman mungonte thuhet se krejtësisht pse kishte shkuar në Itali Por nuk mjafton kaq. Duan edhe që të jenë të sigurtë nga besnikria e kësaj klase së ré. Marin, prandaj, disa nga Shqiptarët më të çquar të çdo vëndi, i u japin rutbera e i u premtojnë pasurira të mëdha tokësh, në qoftë se bëhen myslimanë. Këta, kush më parë e kush më vonë, e pranojnë dëshirën e sundonjsit. Dikuj nuk i duket gjë e kundër-natyrshme ndrrimi i fés, pse me kristjanizmin vetëm emri e lithte. Dikush tjetër porsa lindur është marrë në Stamboll ku është rritur e edukuar në fén e Muhamedit dhe ka hyrë në radhët e Jeniçerve. Dikuj i ka ardhur shpirti në majë të hundës nga ndjekjet e parreshtura të Tyrqvet 54). Ndonjë kryetar fisi e sheh popullin që po vuan shumë nga taksat e rënda e prandaj pranon të ndrrtojë fé për të mos lënë që të heqin keq njerzit e vetë. Misjonarët katolikë që kanë udhtuar nëpër viset t'ona për të mbajtur lartë Kryqin, kanë lënë shumë shënime që pohojnë këto të vërtetas 55).

54) JORGA : «Brève Histoire de l'Albanie», etc, faqe 53.

55) Shif, sidomos, GRANATA : «Op. Cit.», faqe 235 - 236.

Ata shkrimtarë që thonë së Tyrqit nuk e përdorën n'asnjë rasje forcën për të përhapur besimin e tyre duhet të jenë në gabim.

Shohim, në këtë mënyrë, të krijohet në Shqipëri klasa e ré drejtonjse të cilën e lith, nëpër mjet të myslimanizmit, besnikëri e patronditëshme te Sulltani. Krahina të tëra, ku pjesërisht e ku tërësisht, rrokin fén e Muhamedit.

Myslimanizmi për një kohë të gjatë nuk e ndau Shqiptarin nga Shqiptari. Martesat midis dy féve kanë qënë të zakonëshme, dhe vazhdojnë edhe sot në disa malsira. Ka shëmbuj të dëndur që tregojnë se muhamedani e pagzon fshehtazi të birin, ose gruan 56), shkon e falet në kishë, jep ndihmë për mbajtjen e famulltarit 57), jeton nën, një strehë bashkë me kristjanin q'e ka vlla a kushëri 58) dhe, kur vdes, i a lë trashgim monastirit të gjithë pasurin e tij. Ndoth edhe diçka m'e çuditëshme: në një kishë të shndrruar në xhami, Kristjanët mirren vesh me bashkë-qytetasit e tyre që kanë kthyer fé dhe, herë pas here, shkojnë atje me priftin në krye e «i falen Perëndis si pas dogmës së tyre» 59). Një Krahin' e tërë e Elbasanit, Shpati, për të shpëtuar nga ndjekjet tyrke, çfaqet si myslimane duke ndryshuar vetëm emrat e njerzve, kurse fshehtazi e mban të paprekur fén orthodokse. Kriptokristjanët kanë qënë të shumë të numër gjatë shekullit të XVII-të.

Ja shkaqet e përhapjes së besimit të Muhamedit në vëndin t'onë. Kuptohet nga këto se nuk ka asnjë shënj imoraliteti të mbrujtur në gjakun shqiptar, por se rrethanat kanë qënë t'atilla, sa që cilido popull tjetër i ndodhur në këto kushte nuk do të kishte mundur të vepronte ndryshe 60).

56) BORGIA : «Op. Cit.», faqe 55 etj.

57) ROSSI : «Op. Cit.», faqe 207.

58) STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 221

59) Evlija ÇELEBI : "Shqipnija para dy shekujsh», përkthim i Salih Vuçiternit, Tiranë, 1930, faqe 124 - 125. Por këtu shkrimtari turist tyrk bën, pa dashur, një ndërlikim : kujton se kristjanët e Ohrit janë Bullgarë, kurse ne e dimë se ata ishin Shqiptarë. Si do qoftë, toleranca tregohet nga ana e Myslimanve q'ishin, me siguri, të gjakut t'onë.

60) STADTMUELLER-i e përmbledh me këto fjalë procesin e myslimanizimit të Shqiptarve : «Ky kthim i vijueshëm i popullsis n'islamizëm qi u zgjat në Shqipni deri në Luftën Botnore, nuk asht për t'u kundruem si një lëvizje besimtare. Në këtë pikë janë të gjithë shkrimtarët të një mendimit. Arsyet e këtij kthimi ishin të jashtëme, politike dhe ekonomike. Përpara çdo gjaje, me anën e islamizmit kërkohet lirimi nga taksat dhe sigurimi i mprojtjes policore t'autoriteteve tyrke». Shif «Op. Cit.», faqe 221.

Historija mbi racën e një populli nuk do t'ishte e plotë në qoftë se do të përmbante vetëm lëvizjet e sipërfaqes toksore mbi të cilën kjo racë është përhapur ndër kohë të ndryshme dhe ndikimet që ka patur gjatë shekujve prej popujve me të cilët ka rënë në kontakt. Çdo racë, përveç dukjes së jashtme, ka edhe një dukje të mbrëndëshme, shpirtrore, një farë psike të vetën që i jep asaj vulën më të fortë dallonjse dhe i cakton, në pjesën më të madhe, rrugën që duhet të ndjekë në histori.

Kjo psikë e veçantë është e shpërndarë, pak a shumë, në të gjithë përfaqsonjsit e një race. Por seicili ndër këta përfaqsonjës nuk i përmban të gjitha veçorit e mira shpirtrore të sajë. Kush nga këta ka më shumë e kush më pak. E kur një individ është pajosur shumë më tepër nga shokët 'e tij, me këto veçori, kemi një gjeni që përfaqson për bukuri racën së cilës i përket. «Gjenija, në të vërtetën, thot një biolog i math italian, nuk është veçse shprehja e cilsive më të mira shpirtrore, racore e të trashguarshme të fisit, të bashkuara në një njeri 72).»

61) STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 218.

62) Carlo TAGLIAVINI : «Le parlate albanesi di tipo Ghego-orientale (Dardania e Macedonia nord - occidentale) në Le Terre albanesi redente, I, Kossovo, faqe 16.

63) TAGLIAVINI : «Op. Cit.», faqe 14.

64) Vukaniç thot se Shqiptarët e Drenicës ishin malsorë katolikë që u bënë muhamedanë mbas ardhjes së tyre në Sërbi. (TAGLIAVINI : «Op. Cit.», faqe 14.

65) Roberto ALMAGIA : «L'Albania», Romë, 1930, faqe 105.

66) JORGA : «Brève Histoire de l'Albanie», etc. faqe 59. - ALMAGIA : «Op. Cit.», faqe 105. - STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 222.

67) SUFFLAY : «Op. Cit.», faqe 118.

68) STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 222.

69) STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 225.

70) ALMAGIA : «Op. Cit.», faqe 188.

71) Branko MERXHANI : «Roli Historik i Perandoris s'Osmanllive në Ballkan dhe një vështrim mbi historin e Popullit tyrk», VI, n'Illyria, Viti I, Nr. 52, faqe 2.

72) GHIGI : «Op. Cit.», faqe 30.

Ndofta është i vogël numri i bijve të fisit t'onë që janë njohur prej të gjithë botës si gjeni të vërtetë. Pse i vogël është edhe numri i përgjithshëm i popullsis shqiptare. Por njerz të mëdhej që kanë skalitur thellë emrin e tyre në shkëmbin e historis së përbotëshme kemi kaq shumë sa cilido prej nesh duhet të mburret e kërkush në botë nuk ka si të na mohojë meritat.

Një nga intelektualët t'anë më të mirë, i ndyeri Vangjel Koça, ka pas mbajtur një konferencë të rëndësishme me qëllim që t'i bëjë të njohur botës se huaj vlerat e kësaj race. Me shpresë se kjo ligjëratë do të përkthehet e do të botohet edhe në gjuhën shqipe, unë nuk dua të shënoj të gjithë emrat e Shqiptarvet të mëdhenj që numron historia, por po përmënt vetëm e thatas disa ndër ta sa për të treguar se sa të shumta e të mëdha janë vetit me të cilat është pajosur raca e jonë.

Kërkush nuk ka mohuar, gjer më sot, cilsit ushtarake që kemi në gjak. Të përmëndim Lekën e Math, do të gjenim ndokënd që do të thoshte: këta mëndjemëdhenj « kanë dashur të fusin në familjen e gjërë ilirike të të parvet të Shqiptarve të sotshëm edhe ngadhënjensin e math maqedonas, por në këto lavdërime të vonuara nuk është historia që rindërton; janë ëndrrat poetike të fantazis që zbukurojnë » 73), Por për vargun e perandorvet të Romës, ndër të cilët Aureljani, Dioklecjani dhe Kostandini i Math, nuk besoj të ketë njeri që të kundërshtojë origjinën ilire. Gjatë kohës së mesme shumë priesa ushtarakë duhet të kenë qënë Shqiptarë. Reparte të përbëra prej Shqiptarësh ka patur kudo dhe kudo janë dalluar për trimri e qëndresë. Do të mjaftonte vetëm emri i Gjergj Kastriotit për të provuar se trimëria e Shqiptarit nuk është treguar vetëm për të ruajtur tokën e vetë dhe pastrin e racës, por, kur ka qënë nevoja, edhe për të mbrojtur të gjithë krishterimin perndimor nga rreziku m'i tmerrshëm q'i kërcënohej.

Gjatë kohëve të vona kemi një numër shumë të math pashallarësh, me Qypërlinjt në krye, që shpëtojnë nga rreziku Perandorin osmane dhe mbajnë lart emrin e Sulltanit. Arbreshët q'u hodhën n'Itali u shpërndanë shpejtë nëpër Evropë për të shërbyer pranë mbretërve të mëdhenj në bataljonet e stratotëve të komanduar prej gjeneralash gjakut të tyre si Gjergj Basta. Lufta e mvehtësis greke i u dha nam aq të math Arbreshve të vëndit, ose atyreve që porsa kishin shkuar nga Shqipëria orthodoxe për të luftuar kundër Islamit, sa që historjani gjerman Stadtmüller u detyrua të thotë: «Lufta greke për liri nuk munt të mendohet pa elementin shqiptar» 74); një soj siç tha shoku i tij m'i vjetër Fallmerayer-i një shekull më parë: «kryengritja greke e shekullit të XIX-të, që shpëtoi Greqin nga zgjedha tyrke, qe vepër e Shqiptarvet 75).»

Sikur vetëm në fushën e armëve të binte në sy Arbreshi, gjithkush do të kishte të drejtë të thoshte: ja një popull i zoti vetëm për të shkatrruar, për të vënë në zjarm e në flakë ç'a bota me djersë e mund mbleth, ndërton e rregullon. Por edhe ndër fusha të tjera është çquar raca e jonë;ajo ka nxjerë udhëheqës popujsh e politikanë të mëdhej si perandorët e Romës e të Kostantinopolit, familjet princore Gjika e Lupu të Rumanis, Françesk Crispin e Italis, të gjithë pashallarët e Egjyptit që më vonë

u bënë mbretër e sa e sa të tjerë. Raca e jonë ka nxjerë një perandor q'e ka mbajtur gjallë Bizancin me organizatën financjare që krijoi, Anastasin e Durrsit 76), ligjëvënësin më të math të botës, Justinianin 77), projektonjsin e tunelit të Semmeringut Karl Gegën, Nën-Kryetarin e sotshëm t'Akademis Mbretrore t'Italis, shkencëtarin në zë Prof. Valaurin 78) nga Korça. Shqiptarë kanë qënë përkthenjësi i Ungjillit në latinishte Shën Hieronimi, papa Klementi i XI dhe disa patriarkë të Kishës Orthodoxe 79).

73) CORDIGNANO : «Op. Cit.», faqe 27.

74) STADTMUELLER : «Op. Cit.», faqe 222.

75) VASILIEV : «Op. Cit.», tom II, faqe 296.

76) VASILIEV: «Op. Cit.», tom I, faqe 139-145 etj...

77) CORDIGNANO, në studimin e tij që ka mbetur i famshëm për prapamendim, dyshon për origjinën shqiptare të Justinianit (faqe 29), ndërsa VASILIEV-i, një nga njohsit më të thellë të historis bizantine, e vërteton me dokumenta se Ligjëvënsi i math ka qënë i racës ilirike. Shif «Op. Cit.», tom I, faqe 169 - 170.

78) S'besoj të ketë shkruar kush gjer më sot se Prof. Valauri është shqiptar. Pretendimin t'im mbi shqiptarsin e tij e mbështes në të thënat e zotrinjve Loni Xoxa nga Fieri dhe Prof. Naun Stralla nga Korça. I ati i Valaurit (Ballaurit) larguar nga Voskopoja e Korçës, mirrej në Brindisi me tregëti zhuke e gjëje të gjallë që i dërgoheshin prej Myzeqeje. Dy të bijt e tij, nga të cilët fizikani i math ,i janë pagzuar prej së motrës së Z. Loni Xoxa. Në Korçë ka edhe sot shumë nga farefisi i tij.

79) Faik KONICA : «Një patriark shqiptar në shekull të XV-të» në Bota Shqiptare, faqe 555.

As në letra e harte Shqiptarët nuk kanë mbetur prapa së tjerësh. Arkitektat Mika Petrab prej Tivarit, Aleksandër Aleksi prej Durrësit, ndërtonjësi i xhamivet më të bukura të Stambollit, Mimar Sinani 80) prej Sulove, piktori në zë Francesk Albani, humanistët Gjon Gazulli, Marin Beçikemi e Marin Barleti, skulptori Gjon Albani, poeti Mihail Eminescu 81), dramaturgu Viktor Eftimiu 82) dhe artisti më i math tragjik që ka pasur bota në këta vjetët e fundit, Aleksandër Mojsiu prej Durrësi, janë që të gjithë bij të kësaj race.

Shihet nga këta pak rreshta se raca shqiptare nuk ka nxjerë vetëm burra të pushkës, por edhe njerz të mëndjes e të shpirtit, filozofë, ligjvënës, burra shteti, shkencëtarë, letrarë, dijetarë, poetë e artistë të mëdhenj. Numrit të njerzve të dëgjuar që njihen si Shqiptarë duhet t'i shtohet një numër tjetër shumë m'i math të panjohurish, që janë mbajtur si pjellë e ndonjë populli tjetër dhe që ne nuk u a dimë emrat.

Kontributi që kjo racë i ka sjellë botës, në përpjestim me numrin e me kushtet në të cilat ka jetuar, nuk e vë prapa racavet të tjera fqinje. Tregon, për kundrazi, se paja. Shpirtrore e sajë është e madhe dhe e shumanëshme.

80) Origjina shqiptare e Arkitektit Sinan është vërtetuar nga Abdurrahman Sherif Beu, historiograf i math dhe kryetar i Shoqëris së Historis otomane. Shif Lumo SKËNDO : «Les Albanais chez eux et a rétranger», Lausanne, 1919, faqe 25.

81) Mitrush KUTELI : Mihail Eminescu, Viersha, Kostancë, 1939. faqe 13, 14, 15.

82) «Bota Shqiptare», faqe 531.